



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE

УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА

SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

TEZË MASTER

**NDIKIMI I INFLACIONIT DHE RITJES EKONOMIKE NË
PAPUNËSINË NË RASTIN E MAQEDONISË SË VERIUT**

Kandidat:

Erijona Bojku

Mentor:

Prof. Asoc. Dr. Hyrije Abazi Alili

Tetovë, Qershor 2021

Deklaratë

Unë deklaroj se ky hulumtim master është punuar nga vetë unë dhe i kam dokumentuar të gjithë burimet dhe materialet e përdorura në bibliografi. Kjo tezë nuk është paraqitur më parë nga një tjetër person dhe nuk është botuar më parë. Kam përdorur mendime nga burime të jashtme direkte ose indirekte. Në përzgjedhjen dhe vlerësimin e material kërkimorë unë kam marrë shërbime mbështetëse nga mentorja ime. Unë jam e vetëdijshme se çdo shkelje e këtyre rregullave do të realizoj në anulimin të punimit dhe do të konsiderohet mashtrim.

Vendi dhe Data

Nënshkrimi

Mirënjohje

Në fillim e gjithë mirënjohja ime shkon për Zotin e Plotfuqishëm duke më dhënë shëndet, forcë dhe vullnet për të përfunduar këtë hulumtim master.

Është e natyrshme që për të realizuar një punim master të duhet kohë dhe mund, por është e rëndësishme të shprehësh mirënjohje ndaj individëve që shpenzojnë kohën e tyre për të më ofruar ndihmë.

Dëshiroj të shpreh faleminderimet e mija të sinqerta, Prof. Asoc.Dr. Hyrije Abazi-Alili, për ndihmën, këshillat dhe përkrahjen e saj, e cila më inkurajoi, udhëzoi dhe më mbështeti gjatë kohë së realizimit të këtij punimi, pa ndihmën e saj nuk do të mund ta realizoja këtë hulumtim shkencor. Faleminderoj gjithashtu edhe anëtarët e komisionit, Shenaj Haxhimustafa dhe Shpresa Syla.

Shum faleminderime drejtohen edhe për familjen time, për prindërit e mij që më përkrahën dhe më motivuan vazhdimisht në këtë drejtim.

Abstrakti

Papunësia është një nga problemet më të vështira socio-ekonomike me të cilën përballen shumë vende në botë. Shkalla e papunësisë sjell me vete një sërë problemesh të tjera të tilla si: varfëria, pasiguria sociale e cila nga ana e saj rezulton me një cilësi të ulët të jetës së popullsisë, gjithashtu ndikon në përdorimin e burimeve dhe rritjen ekonomike.

Për shkak të shkallës së ulët të punësimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, një nga shtyllat e politikës makroekonomike janë programet e punësimit. Krijimi i një klime pozitive dhe krijimi i mekanizmave të caktuar në tregun e punës inkurajon investitorët, vendasit dhe të huajt, të investojnë dhe kështu të krijojnë vende të reja të punës.

Shkalla e lartë e papunësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut na tregon se situata makroekonomike është e brishtë, dmth që është pjesërishtë e qëndrueshme. Sidoqoftë, duhet të vërejmë gjithashtu se për shkak të politikave aktive të tregut të punës, papunësia në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka një trend rënie, dmth ajo është në rënie të vazhdueshme, e cila është shenjë e mirë për rimëkëmbjen e ekonomisë sonë.

Qëllimi i punimit është të analizojë lidhjen dhe ndikimin që ka inflacioni dhe rritja ekonomike në papunësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Për të provuar këtë lidhje, bazuar në literaturë teorike u ndërtua një model ekonometrik duke shfrytëzuar të dhënat tremujore për periudhën kohore 2004 – 2019.

Punimi arrin në përfundim që në Rastin e Republikës së Maqedonisë së Veriut egziston një lidhje negative mes inflacionit dhe papunësisë për periudhën kohore 2004 – 2019. Gjithashtu nga rezultatet e modelit u provua që egziston një lidhje negative midis rritjes ekonomike dhe papunësisë.

Абстракт

Невработеноста е еден од најтешките социо-економски проблеми со кои се соочуваат многу земји во светот. Стапката на невработеност носи со себе и низа други проблеми како што се: сиромаштија, социјална несигурност, што пак резултира со низок квалитет на живот на населението, исто така влијае на употребата на ресурсите и економскиот раст.

Поради ниската стапка на вработеност во Република Северна Македонија, еден од столбовите на макроекономската политика се програмите за вработување. Создавање позитивна клима и воспоставување одредени механизми на пазарот на трудот ги охрабрува инвеститорите, локалното население и странците, да инвестираат и на тој начин да отворат нови работни места.

Високата стапка на невработеност во Република Северна Македонија ни покажува дека макроекономската состојба е кривка, односно дека е делумно стабилна. Сепак, мора да нагласиме и дека поради активните политики на пазарот на трудот, невработеноста во Република Северна Македонија има тренд на опаѓање, односно постојано опаѓа, што е добар знак за закрепнување на нашата економија.

Целта на овој труд е да се анализира врската и влијанието на инфлацијата и економскиот раст врз невработеноста во Република Северна Македонија. За да се тестира овој однос, заснован на теоретската литература, беше конструиран економетриски модел со употреба на квартални податоци за периодот 2004-2019 година.

Во трудот се заклучува дека во случајот на Република Северна Македонија постои негативна врска помеѓу инфлацијата и невработеноста за периодот 2004 - 2019 година. Исто така, резултатите од моделот покажаа дека постои негативна врска помеѓу економскиот раст и невработеноста.

Abstract

Unemployment is one of the most serious socio-economic problems faced by many countries in the world. Unemployment rate brings with it a number of other problems such as: poverty, social insecurity, which in turn results in low quality of life of the population, also affects resource use and economic growth.

Due to the low employment rate in the Republic of Northern Macedonia, one of the pillars of macroeconomic policy is employment programs. Creating a positive climate and establishing certain mechanisms in the labor market encourages investors, locals and foreigners to invest and thus create new jobs.

The high unemployment rate in the Republic of Northern Macedonia shows us that the macroeconomic situation is fragile, ie that it is partially stable. However, we must emphasize that due to the active labor market policy, unemployment in the Republic of Northern Macedonia has a downward trend, ie a continuous decline, which is a good sign for the recovery of our economy.

The purpose of this paper is to analyze the relationship and impact of inflation and economic growth on unemployment in the Republic of Northern Macedonia. To test this relationship, based on the theoretical literature, an econometric model was constructed using quarterly data for the period 2004-2019.

The document concludes that in the case of the Republic of Northern Macedonia there is a negative relationship between inflation and unemployment for the period 2004-2019. Also, the results of the model showed that there is a negative relationship between economic growth and unemployment.

Përmbajtja

Deklaratë.....	2
Mirënjohje.....	3
Abstrakti.....	4
Абстракт.....	5
Abstract.....	6
Lista e Figurave.....	9
Lista e Tabelave	10
1.HYRJE.....	11
1.1 Rëndësia dhe qëllimi kryesor i hulumtimit.....	11
1.2 Objektivat e veçanta dhe rezultatet e pritshme	12
1.3 Organizimi i hulumtimit	13
1.4 Metodologjia dhe burimi i të dhënave	14
2.RISHIKIMI i LITERATURËS	15
2.1 Papunësia	15
2.2 Kostot e papunësisë	17
2.2.1 Kostot ekonomike të papunësisë	17
2.2.2 Kostot sociale të papunësisë	18
2.3 Format e papunësisë	18
2.3.1 Papunësia friksionale	19
2.3.2 Papunësia strukturore.....	20
2.3.3 Papunësia ciklike.....	21
2.3.4 Papunësia sezonale	22
2.4 Papunësia e vullnetshme dhe papunësia e detyruar	22
2.5 Shkaqet e papunësisë në ekonominë e Maqedonisë së Veriut	24

2.6 Kurba e Philips-it, mbi raportin inflacion-papunësi	24
2.6.1 Kurba e Philips-it, marrëdhëniet ndërmjet inflacionit dhe papunësisë në afat të shkurtër...	26
2.6.2 Kurba e Philips-it, marrëdhëniet ndërmjet inflacionit dhe papunësisë në afat të gjatë.....	27
2.8 Ligji i Okun-it, mbi lidhjen papunësi dhe rritje ekonomike	29
3.ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE NË VITIN 2019	31
3.1 PBB dhe inflacioni	31
3.2 Tregu i punës	36
3.3 Papunësia në Republikën e Maqedonisë së Veriut	38
3.3.1 Papunësia sipas gjinisë	40
3.3.2 Papunësia sipas nivelit të edukimit	42
3.4 Inflacioni në Republikën e Maqedonisë së Veriut	43
3.5 Politikat e Tregut të punës në Maqedoninë e Veriut	47
3.5.1 Politikat aktive të tregut të punës në Maqedoninë e Veriut	47
3.5.2 Politikat pasive të tregut të punës në Maqedoninë e Veriut	52
4. VLERËSIMI EKONOMETRIK I HULUMTIMIT	53
4.1 Zgjedhja e variablave të modelit dhe metodologjia	53
4.2. Ndërtimi i modelit ekonometrik për të shpjeguar ndikimi e inflacionit dhe rritjes ekonomike në Papunësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut	55
4.2.1 Përfundime në lidhje me modelin	59
5. Përfundime dhe rekomandime	60
Referencat	62

Lista e figurave

Figura: 1 Prurjet dhe derdhjet e forcës punëtore në një ekonomi kombëtare

Figura: 2 Llojet e papunësisë+

Figura: 3 Papunësia e vullnetshme dhe papunësia e detyruar

Figura: 4 Kurba e Philips-it

Figura: 5 Kurba e Philips-it në afat të shkurtër

Figura: 6 Kurba e Philips-it në afat të gjatë

Figura: 7 PBB dhe kërkesa efektive e huaj (normat reale vjetore të ndryshimit, në %)

Figura: 8 PBB (rritja reale në %) dhe përbërësit e shpenzimeve të PBB (kontributet në rritje)

Figura: 9 Kontributet në rritje reale të PBB-së

Figura: 10 Inflacioni i brendshëm dhe inflacioni efektiv i huaj, ritmet e rritjes vjetore në %

Figura: 11 Ndryshimi (ushqim dhe energji) dhe përbërësit afatgjatë të inflacionit

Figura: 12 Treguesit e zgjedhur të punës

Figura: 13 Shkalla e papunësis sipas grupeve të moshës në %

Figura: 14 Pagat mesatare bruto dhe neto, ndryshimet vjetore në %

Figura: 15 Papunësia dhe Pasiviteti i të rinjve

Figura: 16 Norma e inflacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (1994-2021)

Figura: 17 Histogrami i modelit ekonometrik

Lista e tabelave

Tabela: 1 Norma e papunësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (1997-2019).

Tabela: 2 Normat e PBB-së reale në Republikën e Maqedonisië së Veriut (2000-2019)

Tabela: 3 Normat e aktivitetit të popoullsisë, punësimit dhe papunësisi sipas gjinisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2004-2019).

Tabela: 4 Struktura e papunësisë sipas nivelit të edukimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2016/2017).

Tabela: 5 Norma e inflacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2000-2019)

Tabela: 6 T-testi për rëndësin statistikore të modelit.

Tabela: 7 Vlerësimi i modelit me metodën e Kartorëve më të vegjël.

1.HYRJJE

1.1 Rëndësia dhe qëllimi kryesor i hulumtimit

Tre nga temat kryesore që përbëjnë bazën e studimeve makroekonomike janë: elementet përcaktues të nivelit të rritjes së produktit të përgjithshëm kombëtar, inflacioni dhe papunësia. Nga këto tema inflacioni dhe papunësia janë problemet ekonomike më të mprehta për opinionin publik. Një mates i shkallës së problemeve të paraqitura nga inflacioni dhe papunësia është treguesi i mënyrës së jetesës i shprehur nga shuma e nivelit të papunësisë dhe nivelit të inflacionit. Kur ky tregues është i lartë, këto problem duhet të konsiderohen si problemet bazë të politikave ekonomike qeveritare.

Nëse fenomeni i papunësisë godet kryesisht vetëm disa grupe të popullsisë, inflacioni në të kundërt ndikon mbi gjithë popullatën. Në ekonomitë modern bëhet shumë për zbutjen e ndikimit të situatave inflacioniste. Normalisht, në situata të larta inflacioniste, nëpërmjet sindikatave punonjësit arrijnë të marrin paga më të larta, të cilat synojnë të kompensojnë rritjen e çmimeve, veprim ky që njihet si indeksimi i pagave mbi bazën e inflacionit. Por, megjithatë funksionimin e këtij mekanizmi zbutës apo asimilues, lufta kundër inflacionit merr gjithnjë një rëndësi të dorës së pare, pasi që:

- Së pari, ka gjithnjë grupe shoqëruese që vuajnë vazhdimishtë dhe drejtpërdrejtë pasojat e tij, rast tipik janë pensionistët si dhe zotëruesit e kapitaleve në para.
- Së dyti, kur norma e inflacionit rritet shpejtë, institucionet apo individët kreditorë humbasin, e në të kundërt debitorët fitojnë
- Së treti, gjithë ekonomia destabilizohet nën efektin e normave të larta të inflacionit dhe çmimet e prodhimit dhe të shitjes nuk mund të sinkronizohen lehtë në kohë.

Ekonomia tashmë ka mësuar të bashkëjetojë me inflacionin, prandaj para ekonomistëve shtrohet pyetja nëse është e nevojshme ose jo të tentohet një nivel i moderuar inflacioni, pasi tendenca për të ndaluar inflacionin qon shpesh në një keqësim të këtij fenomeni. Megjithatë, në përgjithësi mbizotëron ideja se nivelet dy shifrore të inflacionit janë simptoma të një ekonomie që funksionon keq.

Inflacioni dhe papunësia shërbejnë shpesh si tregues të vlerësimit të përgjithshëm të gjendjes së një sistemi ekonomik. Nga pikëpamja ekonomike, një papunësi e lartë nënkupton një rënie të PBB-së aktuale nën PBB-në potenciale. Sa më i lartë të jetë niveli i papunësisë, aq më i madh do të jetë hendeku ndërmjet PBB-së aktuale dhe PBB-së potenciale. Kjo lidhje e papunësisë me PBB-në sipas ligjit të Okun-it shprehet në një rënie të papunësisë me 1% për çdo 2% rënie të PBB-së aktuale ndaj PBB-së potenciale. Për më tepër, në dallim nga burimet tjera të prodhimit, puna mund të konsiderohet si burim më pak i zëvendësueshëm. Humbjet ekonomike të shkaktuara nga papunësia vlerësohen më të mëdha se humbjet e shkaktuara nga inefficiencia e ndërmarrjeve.

Nga ana tjetër papunësia shoqërohet edhe me kosto suplementare financiare që qeveria i përdor për dhënie ndihmë financiare të papunëve. Zvogëlimi i të ardhurave personale si rezultat i humbjes së vendit të punës, përbën një nga kostot e dukshme të papunësisë. Krahas kostove ekonomike, papunësia shoqërohet edhe me kostot e saj sociale, si zhvlerësimi i kapitalit njerëzor (humbje të shkallës së arsimimit dhe aftësisë), ulje të dinjitetit personal dhe vetëvlerësim, si edhe rritje të mundshme të kriminalitetit.

1.2 Objektivat e veçanta dhe rezultatet e pritshme

Papunësia paraqet problem serioz ekonomik. Ajo është indikator rrëfyës për dinamikën e zhvillimit ekonomik. Vendet e zhvilluara zakonisht karakterizohen me norma të ulta të papunësisë, përkundrazi ekonomitë jo mjaftë të zhvilluara i përcjellin normat e larta të papunësisë. Ajo prezanton edhe fazat ciklike të zhvillimit ekonomik. Në recesionet ekonomike normat e papunësisë rriten, përkundrazi në preiudhën e progresit ekonomik hapen vende të reja të punës dhe zvogëlohen normat e papunësisë.

Papunësia paraqet formën më drastike të pabarazisë sociale. Personat e papunë ndihen të tepërt dhe si të tillë janë të varur. Ato janë vetëm konsumues dhe paraqesin barrë për të gjithë shoqërinë. Papunësia ka pasoja tejet të rënda për stabilitetin shoqëror dhe ekonomik. Shtetet me papunësi të ulët kanë edhe stabilitet shoqëror, ndërsa shtetet me papunësi të lartë karakterizohen nga tensionet sociale dhe mungesa e stabilitetit shoqëror. Papunësia, si një dukuri e përgjithshme shoqërore, tanimë për një kohë më të gjatë, është e pranishme në të gjitha vendet e botës, te të gjitha popujt dhe shtetet, pa marrë parasysh nivelin e zhvillimit dhe rregullimin shoqëror-ekonomik të tyre. Papunësia si fenomen shoqëror është e pranishme në mbarë botën prej një kohe të gjatë dhe shpeshherë shumë shtete kanë qenë të detyruara të bëjnë mobilizim jashtëzakonisht të madh për eliminimin apo tejkalimin e kësaj dukurie shoqërore.

Inflacioni dhe papunësia shërbejnë shpesh si tregues të vlerësimit të përgjithshëm të gjendjes së një sistemi ekonomik. Nga pikëpamja ekonomike, një papunësi e lartë nënkupton një rënie të PBB-së aktuale nën PBB-në potenciale. Sa më i lartë të jetë niveli i papunësisë, aq më i madh do të jetë hendeku ndërmjet PBB-së aktuale dhe PBB-së potenciale. Kjo lidhje e papunësisë me PBB-në sipas ligjit të Okun-it shprehet në një rënie të papunësisë me 1% qon në 2% rënie të PBB-së aktuale ndaj PBB-së potenciale. Për më tepër, në dallim nga burimet tjera të prodhimit, puna mund të konsiderohet si burim më pak i zëvendësueshëm. Humbjet ekonomike të shkaktuara nga papunësia vlerësohen më të mëdha se humbjet e shkaktuara nga inefficienca e ndërmarrjeve.

Qëllimi i çdo ekonomike është që të arrijë një zhvillim të qëndrueshëm, gjë kjo që kërkon arritjen e një normë të ulët të papunësisë dhe të inflacionit, pasi në shumicën e studimeve, norma e papunësisë ka lidhje të zhdrejtë me inflacionin dhe rritjen ekonomike.

Për këtë arsye, qëllimi i këtij punimi është të analizojë pikërisht marrëdhënien e këtyre treguesve, duke theksuar ndikimin që kanë inflacioni dhe rritja ekonomike te papunësia dhe të gjitha ato mangësi që shkaktohen nga papunësia dhe inflacioni, si dhe nxjerrjen në pah të rrugës më të mirë për tejkalimin e këtyre problemeve kaq shqetësuese për ekonomin e një vendi. Qëllimi i këtij punimi është tju japë përgjigje këtyre pyetjeve kryesore:

- Si është lidhja dhe ndikimi i inflacionit në papunësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut?
- Si është lidhja dhe ndikimi i rritjes ekonomike në papunësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut?
- Çfarë politikash dhe masash duket të merren nga qeveria për uljen e papunësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut?

1.3 Organizimi i hulumtimit

Kapitulli i parë është kapitulli hyrës i punimit, në të cilin do të trajtohen rëndësia dhe qëllimi kryesor i hulumtimit, objektivat e veçanta dhe rezultatet e pritshme, organizimi i hulumtimit, metodologjia e përdorur, dhe burimet e të dhënave.

Në kapitullin e dytë do të trajtohet literatura bazë që ka të bëjë me temën, duke filluar me zhvillimet e fundit botërore makroekonomike për sa i përket papunësisë, inflacionit dhe rritjes ekonomike duke vazhduar me tej me përkufizimet e papunësisë, kostot ekonomike dhe sociale të saj, si dhe llojet e papunësisë.

Në kapitullin e tretë do të trajtohen sistemi makroekonomik i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në këtë kapitull do të analizohen tendencat e Produktit të Brendshëm Bruto si tregues i rritjes ekonomike, dhe ecuria e papunësisë dhe inflacioni, si tregues kryesor që ndikojnë në qëndrueshmërin e kësaj rritje.

Në kapitullin e katërt do të ketë një vlerësim ekonometrik të ndikimit të inflacionit dhe rritjes ekonomike në papunësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Vlerësimi ekonometrik bëhet duke shfrytëzuar metodën e Katrorëve më të Vegjël (OLS) përmes një regresioni të shumëfishtë, me të cilin jepen vlerësime të ndikimit të inflacionit dhe rritjes ekonomike në papunësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën prej vitit 2004-2019.

Në kapitullin e pestë do të përmbliidhen rezultatet dhe to të jepen rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjet kryesore dhe diskutimet ngritur gjatë këtij punimi.

1.4 Metodologjia dhe burimi i të dhënave

Ky punim analizon lidhjen dhe ndikimin që ka inflacioni dhe rritja ekonomike në papunësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut duke përdorur tre lloje metodash:

1. **Një analizë teorike** mbi papunësinë si një dukuri shoqërore, forma e papunësisë dhe rolin që kanë treguesit e makroekonomisë si inflacioni dhe rritja ekonomike mbi papunësinë.
2. **Një analizë përshkruese** mbi situatën makroekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, politikat e tregut të punës, reformat strukturore.
3. **Një analizë empirike** duke përdorur një modeli regresioni të bazuar në metodën OLS ku identifikohen lidhjet midis variablave.

Specifikisht, metodologjia e punimit përbëhet nga këto hapa:

- Ndërtimi i pyetjeve kërkimore dhe zhvillimi i tyre.
- Trajtimi i bazave teorike dhe analiza e gjetjeve të literaturës së huaj, dhe studimeve vendase mbi lidhjen papunësi-inflacion dhe papunësi-rritje ekonomike.
- Analiza e problematikës makroekonomike në Maqedoni me fokus papunësisë dhe treguesit makroekonomikë që ndikojnë mbi të.
- Ndërtimi i modelit empirik, grumbullimi, përpunimi i të dhënave dhe nxjerrja e rezultateve.
- Nxjerrja e përfundimeve dhe rekomandimeve.
- Për të përmbushur objektivat e këtij punimi kërkimor është ndërmarrë rishikimi i një literature të gjerë që fokusohet në shpjegimin e kësaj lëmie, si dhe burimet dytësore që përfshijë studimet e më parshme e raste studimi në këtë fushë, raporte, tabela statistikore, baza të dhënash në internet ejt.
- Punimi është bazuar në kërkime e materiale egzistuese nga këto lëmi dhe në të dhëna konkrete sa u përket këtyre treguesve në Republikën e Maqedonisë së Veriut duke zbatuar dhe metoda ekonometike për ndikimin që ka inflacioni dhe rritja ekonomike në papunësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë kësaj periudhe kohore.
- Ky studim përfshin gjithashtu edhe elemente kërkimi sasior, si analiza e të dhëave statistikore dhe përpjeke për të shpjeguar ecuritë dhe për të analizuar tendencat e zhvillimit.
- Për realizimin e këtij punimi janë përdorur të dhëna sekondare, këto të dhëna janë siguruar nga burimet e publikuara dhe janë kryesisht të dhëna nga Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Enti Statistikor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Banka Qëndrore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Financave të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Agjensia për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ejt.

2. RISHIKIMI I LITERATURËS

2.1 Papunësia

Papunësia, paraqet problem serioz ekonomik. Definimi real i papunësisë dhe matja e saj kanë rëndësi të veçantë për ekonominë. Nëse vlerësojmë se personat e papunë janë ato të cilët nuk kanë punë, me siguri që ky nuk është definimi i plotë i papunësisë. Supozoni se jeni i papunë dhe dikush ju ofron punë me mëditje prej 2\$, a do të pranoni, me siguri jo. Nisemi nga një rast tjetër, dikush dëshiron të punojë por është i sëmur dhe nuk është i aftë për punë, ose një studentë dëshiron të punoj, por nuk mund të punojë me orar të plotë. Supozoni se në një lojë fati keni fituar shumë para dhe keni vendosur që deri në fund të jetës të mos punoni, edhe pse paraqiteni si i papunë. Në rastet e sipërpërmendura a llogariteni persona të papunë? Jo!

Të papunë janë ato persona të cilët janë të aftë dhe aktivishtë kërkojnë punë por nuk mund ta gjejë atë. Me fjalë tjera, të papunë janë personat në moshë pune, të aftë dhe që aktivishtë kërkojnë punë. Papunësia matet në dy mënyra si:


- **Kërkesat për kompensim të personave të papunë** që regjistrohen nga agjensitë shtetërore të cilët paguajë transferat e tyre, janë burim i rëndësishëm për nivelin e papunësisë. Shteti mund ti ndryshojë rregullat për transferat e papunësisë, nëse i ashpëron ato papunësia reduktohet dhe anasjelltas, edhe pse gjendja reale nuk ka ndryshuar. Republika e Maqedonisë së Veriut në periudhën e tranzicionit me objektiv reduktimi jo real të papunësisë, disa herë ka ndryshuar rregullat për aplikim të transferave për të papunët.
- **Anketimi i forcës punëtore** është burimi i dytë, ndoshta me relevant për hulumtimet e tregut të punës. Anketimi ka për objektiv mbledhjen e të dhënave për numrin, strukturën dhe karakteristikat e papunësisë aktive dhe jo aktive sipas standarteve ndërkombëtare (ILO). Sipas saj, në ekonominë e Maqedonisë i papunë llogaritet personi i moshës 15-64 vite, i cili në kohë e raportit javor nuk ka punuar në mënyrë aktive, ka kërkuar punë dhe ka qënë i gatshëm të filloj punën brenda 2 javëve. Në ekonominë e Maqedonisë në bazën e anketimit, personi mund të jetë i punësuar, i papunë dhe jashtë forcës punëtore.

Persona të punësuar llogariten ato të cilët në raportet një javore kanë punuar ndonjë punë me të cilën kanë marrë mëditje dhe ato të cilët kanë punuar në biznesin familjar ose në pronën bujqësore dhe nuk janë paguar. Të punësuar llogariten ato persona të cilët janë në marrëdhënie pune dhe paguhen, por për arsye të ndryshme (si sëmundje, pushim mjekësor, grevë, specializim, shërbim ushtarak) përkohësisht kanë ndërprerë marrëdhënien e punës.

Siç u cek më sipër, qeveria nga kërkesat për kompensim disponon të dhëna për papunësinë dhe nga tatimet në të ardhura ka të dhëna për punëtorët e punësuar. Personat e punësuar dhe ata që kërkojnë punë formojë forcën punëtore në një ekonomi kombëtare. Të gjithë personat që nuk

inkuadrohen në kategorinë e të punësuarve dhe atyre që kërkojnë punë (nxënësit, studentët, pensionistët, amviset, persona të cilët përkujdesen nga persona të tjerë ose nga shteti) nuk i takojnë forcës punëtore. Ato përcaktojnë prurjet dhe derdhjet në tregun e punës, të cilët janë prezentuar në figurën më poshtë:

Figura 1. Prurjet dhe derdhjet e forcës punëtore në një ekonomi kombëtare



Burimi: Makroekonomia, Petrit Pollozhani, Tregu i punës dhe papunësia

2.2 Kostot e papunësisë

Kemi cekur më parë se papunësia është anticiklike. Me fjalë tjera, kur ekonomia tkurret rritet papunësia dhe anasjelltas. Nga kjo mund të vërehet se papunësia e ngarkon shtetin më shumë kur ai është më i dobët (në recesion) dhe e ngarkon atë më pak kur është më i fortë (progres). Efektet negative të papunësisë mund ti vërehet nëse analizojmë kostot e saj. Kostot e papunësisë i klasifikojmë në dy grupe:

2.2.1 Kostot ekonomike të papunësisë

Nga pikëpamja ekonomike një papunësi e lartë do të thotë rënje në PBB-në aktuale, pra treguesi i PBB-së aktuale është më i vogël se sa treguesi i PBB-së potenciale. Sa më e madhe të jetë papunësia aq më i madhë është hendeku midis PBB-së aktuale dhe PBB-së potenciale. Kostot ekonomike të papunësisë prezantojnë diferencën e PBB-së aktuale dhe PBB-së potenciale. Me fjalë tjera sa më e lartë të jetë norma e papunësisë aq më e thellë diferenca midis tyre dhe anasjelltas. Të papunët kanë kosto ekonomike sepse ato nuk marrin pjesë në PBB-në por janë pjesëtarë në konsumin e tij. Ato nuk paguajnë tatime personale dhe as kontribute shëndetësore dhe pensionale por ngarkojnë arkën e shtetit, sepse janë shfrytëzues të ndihmave sociale. Humbja e vendit të punës së një kryefamiljari nënkupton një kosto të dukshme ekonomike, sespe redukton të ardhurat familjare. Të papunët bëhen vatra të aktiviteteve kriminale, si kontrabanda me drogë, armë, qenie njerëzore etj.

Më krahasim me burimet e tjera të prodhimit, puna mund të konsiderohet si burim më pak i rezervueshëm. Një ditë pune e humbur për shkak të papunësisë. Është humbur përgjithmonë dhe nuk mund të rifitohet. Kjo karakteristikë e faktorit punë u jep karakter absolut humbjeve nga papunësia. Nga studimet që janë bërë, humbjet ekonomike të shkaktuara nga papunësia vlerësohen të jenë më të mëdha sesa humbjet që pëson shoqëria nga inefiçenca e monopoleve apo humbjet e shkaktuara nga tarifatat dhe kuotat. Në këto kushte norma e papunësisë bëhet një matës i shëndetit ekonomik i një vendi.

Kostoja ekonomike e papunësisë shprehet në këndvështrimin makroekonomik në hendekun e prodhimit, pra në diferencën midis PBB-së aktuale dhe PBB-së potenciale. Kuptohet, në situata papunësie kjo diferencë merr vlera negative.

Një aspekt tjetër ku shfaqen kostot e papunësisë, është dhe fakti se të papunët janë barrë e rëndë financiare për qeverinë, sespe kjo e fundit që përballon fondet për dhënien ndihme financiare për të papunët.

2.2.2 Kostot sociale të papunësisë

Krahas kostove ekonomike, papunësia shoqërohet edhe me kosto sociale, të cilat edhe pse është vështirë të shprehen në vlerë nuk janë më pak se kostot ekonomike. Kostot sociale prezantojnë gjendjen psikologjike të të papunëve. Njeriu i papunë shpesh vuan nga tensioni, zemra dhe sëmundje tjera, sespe është depresiv për paratë dhe kohën e humbur gjatë shkollimit. Ata ndihen të nënçmuar dhe të pavlerë në shoqëri, izoloohen sepse nuk inkuadrohen në rrjedhat ekonomike dhe si aktorë pasivë humbin shpresën për prespektivë. Sipas një studimitë rezultuar nga Kongresi Amerikan është ardhur në përfundim se një rritje e zgjatur e normës së papunësisë nga 6 në 7%

shpien mesatarishtë në: 925 vetëvrasje, 648 vrasje, 20,240 sulme në zemër, 495 të vdekur nga cirroza në mëqi, 4227 pacientë në spitale mentale, 3340 burgosje të reja.


Papunësia shkakton zhvlerësimin e kapitalit human. Një papunësi e zgjatur e ulë në mënyrë serioze vlerën e një investimi të kryer në kapitalin human. Ndodh kështu sepse shkalla e arsimit e fituar dhe e aftësisë për punë e humbin vlerën e tyre kur nuk vihen në përdorim për një kohë të gjatë.

Rritja e papunësisë mund të shërbej si një shtrat i ngrohtë për rritjen e kriminalitetit në shkallë vendi. Një rritje në numrin e të papunëve mund të shkaktojë rritjen e numrit të krimeve. Kur individët nuk marrin të ardhura nga një punë e ligjshme, atëherë ata mund të priren tju drejtoen rrugëve të paligjshme, pra rrugëve të krimit.

2.3 Format e papunësisë

Çdo shtet e lufton papunësinë. Për të ndërtuar politika efikase kundër saj, duhet të njihen burimet e papunësisë. Papunësia është e lidhur ngushtë me forcën punëtore, e cila përfaqëson atë pjesë të popullsisë së vendit që është në moshë pune, që janë të aftë të punojnë dhe që kërkojnë të punojnë. Pra në përgjithësi dallojmë papunësi të vullnetshme dhe papunësi të pavullnetshme ose të detyruar. Papunësia e vullnetshme ka të bëjë me zgjedhjen, përkatësisht vullnetin individual për punën si pasojë e ndryshimeve në pagesën e saj ose për arsye tjera, ndërsa papunësia e detyruar egziston për arsye të gjendjes shoqërore-ekonomike në të cilën operojnë individët, duke përfshirë strukturën e tregut, ndërhyrjen e qeverisë dhe nivelin e kërkesës agregate. Dhe si pasojë e kësaj, nga mënyra e krijimit të papunësisë, dallojmë katër lloje të papunësisë: papunësia friksionale, papunësia strukturoe, papunësia ciklike dhe papunësia sezonale.

Figura: 2 Llojet e papunësisë



2.3.1 Papunësia fraksionale

Papunësia friksionale shfaqet sepse egziston një lëvizshmëri e përhershme e njerëzve midis vendeve të ndryshme të punës dhe të rajoneve. Edhe kur ekonomia është në kushtet e punëzënies së plotë, do të ketë gjithmonë një fluktacion të njerëzve që kërkojnë punë kur diplomohen pas përfundimit të shkollës, ose që lëvizin në rajone apo qytete të ndryshme. Gjithashtu, gratë rikthehen në tregun e punës pas lindjes së fëmijës. Meqënëse me këtë rastë punëtorët e papunë lëvizin midis vendeve të ndryshme të punës ose kërkojnë punë më të mirë, dhe për ta realizuar këtë duhet një farë kohe, thuhet se ata janë të papunë vullnetarë.

Papunësia fraksionale është pasojë e ndryshimeve afatshkurte në tregun e punës, që rezulton nga kërkimi i vendeve më të mira të punës. Kjo lloj papunësie është pasojë e ndryshimeve permanente në ekonomi, prandaj kjo lloj papunësie është vështirë të matet me saktësi. Përderisa egzistojnë mospërputhjet e nevojave të ekonomisë me strukturën arsimore egzistuese të fuqisë punëtore, për aq do të shfaqet kjo lloj papunësie. Sipas S.C. Salop papunësia friksionale është e përhershme, sepse nuk mund të eliminohet as me politika monetare dhe as me ato fiskale dhe sipas mendimit të tijë, kjo lloj papunësie është çdo herë më e vogël nga papunësia e padëshiruar.

Papunësia friksionale është pasojë e kërkesave të ndryshme të bizneseve për fuqi punëtore. P.sh rënia e shitjeve të teshave sportive dhe rritja e shitjeve të teshave elegante do të shoqërohej me mbylljen e vendeve të punës në bizneset sportive dhe rritja e kërkesës për puntorë për bizneset me veshje elegante. punëtorët në industrin e veshjeve sportive do të ngelen papunë, sepse ata nuk kanë njohuri për prodhimin e veshjeve elegante.

Analoge me shembullin e parë, problemin e papunësisë friksionale mund ta vërejmë dhe në aspekte rajonale. P.sh rajonet dallohen nga njëri tjetiri për llojllojshmërinë e të mirave dhe shërbimeve. Disa nga to, në disa periudha mund të kërkohen më shumë e në disa më pak. Varësishtë nga niveli i kërkesës, punësimet në rajone të ndryshme mund të rriten ose ulen. Supozoi se ulen çmimet e naftës, prodhimi i makinave do të rritet, sepse rritet kërkesa për to. Zgjerimi i aktiviteteve të prodhimit të makinave kërkon punëtorë të rinj, por çdo punëtor nuk mund të punësohet se duhet të ketë njohuri paraprake për prodhimin e makinave. Në rastin konkret rritet kërkesa për punë në prodhimin e makinave në ato rajone ku ato prodhohen. Punësimi në këto rajone do të redutohet vetëm nëse rritet çmimi i naftës.

Papunësia friksionale mund të vërehet edhe në aspektin sektorial. Nëse vërejmë periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore, do të vërejmë ndryshime të mëdha në strukturën ekonomike. Sektorët prodhues gjithnjë e më pak kontribuojnë në formimin e PBB, vendin e tyre e zënë sektorët e shërbimeve. Ndryshimet e tilla, rezultojnë me mbylljen e vendeve të punës në sektorët prodhues dhe hapjen e vendeve të punës në sektorin e shërbimeve.

Kjo lloj papunësie është e pashmangshme dhe ekonomisht e justifikueshme, mbasi çon në shpërndarjen dhe rishpërndarjen efektive të burimeve të punës.

Papunësia friksionale është niveli minimal i papunësisë në një shoqëri dinamike, niveli i cili më shumë nuk mund të zvogëlohet. Në esencë kjo formë e lehtë e papunësisë e cila praqitet për shkak se njerëzit nuk mund çdo herë të kenë informacione për vendet e lira apo të sapo liruara të punës, dhe me këtë edhe mundësia për plotësimin e tyre, si dhe për shkak të fluktacionit të vazhdueshëm të të punësuarve nga një vend në një vend tjetër të punës, nga një firmë në tjetër duke kërkuar punësim tjetër i cili do të mundësojë pagë më të lartë dhe kushte më të mira për punë.

2.3.2 Papunësia Strukturore

Papunësia strukturore ndodh sepse egziston një mospërputhje strukturore afatgjate midis kërkesës dhe ofertës për punë. Kjo mos përputhje mund të ndodh sepse kërkesa për një lloj pune rritet ndërkohë që kërkesa për një lloj tjetër pune bie dhe oferta nuk i përshtatet shpejtë këtij ndryshimi. Papunësia strukturore ndodh kur numri i punëve në dispozicion në tregun e punës është i pamjaftueshëm për të punuar gjithëkush që do të dëshironte të punonte. Ajo shkaktohet nga mospërputhja midis aftësive të punëkërkuarve dhe kërkesës së punëve në dispozicion. Kjo pra, është papunësia që krijohet prej përplasjes së kërkesës dhe ofertës për punë. Kërkesa për një lloj pune është rritur në një kohë që kërkesa për atë lloj pune është ulur pa ndryshim oferte.

Këto ndryshime në kërkesën dhe ofertën për punë ndodhin sidomos për shkak të ndryshimeve fundamentale në degët bazë të ekonomisë. Kjo dukuri shoqërohet me rënien e degëve kryesore dhe për pasojë, edhe me vjetërsimin e aftësive apo mjeshtërive të lidhura me to. Problemi bëhet veçanërisht serioz në rajonet ku kanë qënë të koncentruara këto degë. Koncentrimi i degëve depressive të ekonomisë ja lë vendin koncentrimin të papunësisë në këto rajone.

Imobiliteti profesional (mungesa e gadishmërisë dhe vshtirësitë për të braktisur profesionet e vjetra edhe për të përvetësuar profesionet e reja) dhe imobiliteti gjeografik (mungesa e gadishmërisë dhe vshtirësitë lidhur me largimin nga rajonet depressive për arsye sociale, ekonomike.etj), kontribuojnë në ruajtjen e niveleve të larta të papunësisë në rajonet depressive për një kohë të gjatë.

Vetë ndryshimet strukturore në degët e ekonomisë mund të ndodhin për shkaqe të ndryshme, P.sh zhvillimi dhe apilikimi i teknologjive të reja, ndryshimet afatgjate në preferencat e konsumatorëve, etj.

Papunësia strukturore është pasojë e mospërputhjes së ofertës dhe kërkesës për fuqi punëtore në periudha më të gjata kohore. Ndryshimet në ofertë dhe kërkesë për punë rezultojnë nga inkudrimi i të rinjve dhe dalja e gjeneratave të vjetra në (pensionim) nga fuqia punëtore.

Mund të ndodhë që papunësia strukturore të godas vetëm rajonet të cila nuk mund ti përcjellin ndryshimet e caktuara globale strukturore. P.sh në rajonet xehetare të Mbretërisë së Bashkuar me eksploatimin e xeheve shumë minatorë ngelen të papunë dhe ato nuk mund të punësoheshin në sektorin e shërbimeve, arsimit, informative dhe shkencave, sepse nuk dispononin njohurit adekuate. Për minatorët u desh periudhë e gjatë kohore për tu rikualifikuar dhe ndihmuar për të hapur bizneset e tyre private. Shpesh në lajme, revista të ndryshme të Maqedonisë mund të dëgjoni se kërkohen inxhinier, profesor të matematikës ose kuadro tjerë të shkencave egzakte, por nuk ka, nga ana tjetër ka shumë juristë, ekonomistë ose historian të cilët kërkojnë punë.

Papunësia strukturore është afatgjate dhe shumë më e komplikuar nga papunësia friksionale, andaj edhe lufta kundër saj kërkon angazhim më të lart.

2.3.3 Papunësia ciklike

Papunësia ciklike rezulton nga pamjaftueshmëria e përgjithshme në kërkesën agregate. Dihet se kërkesa për punë është një kërkesë e prejardhur. Kjo dot të thotë se një lloj pune kërkohet sepse produkti që ajo prodhon kërkohet. Papunësia ciklike është ajo papunësi, e cila shkaktohet nga ndryshimi në fazat e ciklit të biznesit.

Papunësia ciklike e cila shfaqet nga lëvizjet ciklike të ekonomisë. Kemi cekur më herët se papunësia është anticiklike, pra lëviz në drejtim të kundërt me ciklin, P.sh në ciklin e recesionit, rritet papunësia sepse aktivitetet tkuren dhe bizneset largojnë punëtorët nga puna. Përkundrazi në fazat e prosperitetit, papunësia bie sepse aktivitetet ekonomike zgjerohen dhe hapen vende të reja pune.

Kjo do të thotë se kjo papunësi është pasojë e mungesës së vendeve të lira të punës apo e një niveli të pamjaftueshëm të kërkesës agregate, që në esence paraqet një papunësi të detyrueshme apo të pavullnetshme.

2.3.4 Papunësia sezonale

Papunësia sezonale lidhet me karakterin stinor të prodhimit. Kjo formë e papunësisë shfaqet në degët e industrisë së ndërtimit, në bujqësi, në shërbime, në turizëm etj, sepse në këto degë karakteri stinor i prodhimit dhe kushtet e motit përcaktojnë edhe kërkesën për punë.

Papunësia sezonale paraqitet gjatë sezonave të caktuara brenda vitit. P.sh në viset me klimë tropikale vizita e shtruar e turistëve gjatë verës kërkon forcë punëtore dhe hapen vende të reja të punës, gjatë dimrit zvogëlohet numri i turistëve dhe papunësia rritet. Në vendet me klimë të

ftohtë, vizitat e turistëve gjatë dimrit rriten dhe ofertat e rritura hapin vende pune të reja, gjatë verës numri i turistëve tkurret dhe papunësia rritet.

2.4 Papunësia e vullnetshme dhe papunësia e detyruar


Siç e kemi vërejtur më parë, në tregun e të mirave dhe shërbimeve tregu arrinte ekulibirin me luhajtjen e lirë të ofertës dhe të kërkesës. Në tregun e punës një balancim i tillë vështirë realizohet, sepse ai është më specifik. P.sh shum firma ndërtimi kërkojnë inxhinier dhe shumë spitale kërkojnë kirurgë, por as të parët dhe as të dytët nuk mund ti gjejnë. Punëtorët e rafinerisë së naftës janë gati të punojnë me pagë egzistuese, por nuk gjejë punë, sepse nuk ka kërkesë.

Nga kjo që u cek më sipër mund të vërejmë se tregu i punës është më specifik nga tregu i të mirave dhe shërbimeve. Përderisa te tregu i të mirave dhe shërbimeve, çmimet mund të ndryshojnë shpejtë sipas ofertës dhe kërkesës, në tregun e punës mëditjet, si çmimi i punës nuk mund të ndryshojnë aq shpejtë. Shkaqet e papunësië sipas disa ekonomistëve lidhen me ngurtësin e pagave, jo fleksibiliteti i tyre rezulton me papunësi të vullnetshme.

Sipas një pikëpamje tjetër, pagat janë fleksibile (të ndryshueshme) dhe papunësia ka karakter të detyruar.

Siç mund ta vërejmë, në të dyja rastet kurba e ofertës së punës bëhet plotësishtë jo elastike kur niveli i pagave është i lartë. Për pagat e ulëta oferta e fuqisë punëtore bie ndërsa kërkesa rritet dhe anasjelltas.

Figura: 3 Papunësia e vullnetshme dhe papunësia e detyruar



Papunësia e vullnetshme prezantohet në figurën e parë, kurba e ofertës dhe ajo e kërkesës priten në pikën ekuilibër E e cila korrespondon me nivelin e pagës W. Në këtë nivel page firmat e biznesit janë të gatshme të punësojnë të gjithë punëtorët të cilët duan të punojn, por të papunët do të pranonin të punonin vetëm me paga më të larta. Në figurë numri i punëtorëve paraqet segmentin AE, ndërsa segmenti EB paraqet papunësin e vullnetshme e cila rezulton nga niveli i pagës ekuilibër. Për sa kohë që niveli i pagës qëndron në pozitën W, një pjesë e punëtorëve nuk do të ofrojnë punë dhe kjo quhet papunësi e vullnetshme. Arsyet mund të jenë të natyrave të ndryshme, si p.sh asistenca sociale e përafërt me rrogën, kostoja e lartë e sakrificës së kohës së lirë për pagë të ulët etj.

Papunësia e detyruar prezantohet në figurën e dytë. Siç mund të vërejmë papunësia e vullnetshme, me rritjen e të ardhurave W, shëndrrohet papunësi të detyruar (H, G). Me rritjen e pagave të papunët duan të punësohen, por smunden, sepse çdo rritje e të ardhurave rrit koston dhe redukton fitimet e bizneseve. Punëtorët e zënë në punë paraqiten në segmentin A, H, pjesa tjetër H, G paraqet papunësinë e detyruar dhe segmenti G paraqet papunësin e vullnetshme e cila është shumë më e ulët krahasuar me figurën e parë. Kur të ardhurat e punëtorëve ishin më të ulta, puna e vullnetshme me rritjen e pagave ndjeshëm kanë rënë. Kur në treg rriten mëditjet, firmat e biznesit do të kenë kritet më rigoroz për punësim, sepse rriten kostot e prodhimit.

2.5 Shkaqet e papunësisë në ekonominë e Maqedonisë së Veriut

Për asnjë çështje tjetër të teorisë ekonomike, ekonomistët nuk i kundërvihen kaq shumë njëri tjetrit sa sa për çështjem lidhur me shkaqet e papunësisë. Në tregun e mallrave një ekuilibër i prishur rivendoset, ndër të tjera, duke ngritur apo ulur çmimet.

Për ti dhënë përgjigje kësaj pyetje duhet të mbajmë parasyshë bazat mikroekonomike të papunësisë. Përgjithësisht pranohet se në sjelljen e faktorit punë një rol përcaktues luajnë pagat. Por pikërishtë këtu fillon dallimi midis ekonomistëve lidhur me shpjegimin e papunësisë dhe natyrën e saj.

Sipas njërës pikëpamje shkak i papunësisë duhet kërkuar në ngurtësimin e pagave. Pagat jo fleksibile i japin papunësisë karakter të detyruar. Sipas pikëpamjes tjetër, pagat janë fleksibile, jo të ngurtësuara dhe në këto kushte papunësia nuk mund të konsiderohet e detyruar por si papunësi e vullnetshme.

Normat e larta të papunësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut rezultojnë nga procesi tepër i gjatë dhe jo efikas i tranzicionit. Privatizimi jo i sukseshëm, niveli i ulët i investimeve të jashtme, akumulimi i dobët i ekonomisë kombëtare, mungesa e strategjive konkrete për zbutjen e papunësisë, prania e korrupsionit dhe nepotizmit, sistemi jo efikas i drejtësisë, mungesa e menaxhimit të mirëfilltë të bizneseve, sigurimi i dobët i kapitalit, politikat e shtrënguara monetare dhe politizmi i skajshëm, janë vatrave kryesore të normave të larta të papunësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Vlerësoj se ato duhen pranuar me rezerva, sepse është e pranishme papunësia vullnetare për shkak të pagave të ulta, jo stimuluese dhe nga ana tjetër kriteret e evidentimit të të papunëve herë herë ndryshon. Ndryshimet janë të motivuara për të treguar normat më të ulëta të papunësisë nga ato real. P.sh paraqitja e të papunëve në çdo 3 muaj dhe çdo 6 muaj, keto objektiva të tregojë norma më të ulëta të papunësisë, sespe këto të fundit fare nuk evidentohen si të papunë.

2.6 Kurba e Philips-it, mbi raportin inflacion –papunësi

Punëzënia e plotë dhe stabiliteti i çmimeve janë dy nga objektivat qendrore makroekonomike të çdo qeverie. Për të luftuar papunësinë personat përgjegjës të politikës ekonomike kërkojnë shpesh ti japin një impuls ekonomisë. Me zvogëlimin e kësaj papunësie, sistemi ekonomik i afrohet përdorimit të plotë të aftësive të tijë dhe tregu i punës fillon të ezaurohet. Një numër i madh ndërmarrjesh gjejnë vështirësi në gjetjen e punëtorëve të kualifikuar në kushtet e një konkurrence të lartë, pagat fillojnë të rriten. Kështu një papunësi në nivele të ulta qon në rritjen e pagave, e cila përmes spirales inflacioniste, gjeneron vetë një rritje të çmimeve. Egziston kështu një lidhje inverse ndërmjet papunësisë dhe inflacionit: nivelet e ulëta të papunësisë do të shoqërohen me nivele të larta të inflacionit.

Në objektivat makroekonomike është cekur se qeveria e lufton edhe papunësinë edhe inflacionin, si dy sëmundje të rënda ekonomike. Qeveria harton politikat makroekonomike për ti menjanuar ato ose për të zbutur efektin e tyre.

Kjo marrëdhënie është quajtur kurba e Philips-it, sipas emrit të ekonomistit që analizoi marrëdhënien ndërmjet papunësisë dhe inflacionit të Britanisë së Madhe në vitet 1861-1957. Kërkimet e tij tregojnë mundësit e arritjes së një niveli të ulët të inflacionit, por me një çmim – një nivel të lartë të papunësisë. Të dhënat e analizuar nga Philips rezultuan se pagat (pra dhe çmimet) mund të jenë stabile por me një nivel papunësie prej rreth 5,5%. Kur niveli i papunësisë gjendet në një pike pranë vlerës zero, niveli i inflacionit bëhet jashzakonishtë i lart. Niveli i papunësisë për një nivel zero të inflacionit quhet norma natyrore e papunësisë. Për një nivel të ulët të papunësisë, niveli i çmimeve tenton të rritet dhe për një nivel të lartë çmimet tentojnë të zbresin.


Norma natyrore e papunësisë (NNP) përbën edhe një koncept kryesor të makroekonomisë. Ajo përfaqëson atë normë të papunësisë për të cilën tregjet e punës dhe të mirave janë të balancuara.

Kjo normë e papunësisë:

- Së pari, është më e madhe se zero, pra edhe në një shoqëri me një punëzënie të lartë, një numër i caktuar individësh të forces punëtore do të jenë të papunë në formën e papunësisë friksionale apo papunësisë strukturore.
- Së dyti, norma natyrore e papunësisë është e lidhur ngushtë me inflacionin. Shoqëria do të preferonte një papunësi të ulët por jo aq sa të rrezikonte lindjen e një inflacioni të paparashikuar. Pra norma natyrore e papunësisë përfaqëson nivelin më të ulët të papunësisë që mund të arritet pa rrezikun e akselerimit të inflacionit jo të pritshëm.

Masa në të cilën duhet ti afrohem normës natyrore, nvalet nga inflacioni shtesë me të cilën ai shoqërohet. Nëse kurba e Philips-it do të jetë mjaftë e pjerrët, atëherë kostot me të cilat do të paguhen zvoglimi i papunësisë, do të jetë e lartë dhe në të kundërt, luftimi i inflacionit do të qonte në një nivel më të lartë të papunësisë.

Figura: 4 Kurba e Philips-it.



Në zhvendosjet e kurbës së Philips-it, vlejné të njejtat principe të vlerësuara në lidhje me kurbat e kërkesës dhe ofertës. Kështu që, është përsëri mjaftë i rëndësishëm dallimi ndërmjet lëvizjes gjatë kurbës dhe spostimit të kurbës së Philips-it. Në figurë tregohet një lëvizje nga pika A e kurbës së Philips-it te pika B. Duke qënë se kurba është spostuar lartë në pikën B kemi më shumë papunësi dhe inflacion se në pikën A.

Në përgjithësi arsyet e spostimeve të kurbës së Philips-it janë;

- Së pari, të ashtuquajturit faktorë realë si ndryshimet në kohë, në përmasat dhe përbërjet e forcës së aftë për punë dhe shpejtësia me të cilën këto subjekte janë të afta të spostohen nga një punë në tjetrën (të influencuara edhe nga progresi teknik, i cili rrit nevojën e kapaciteteve teknike të fuqisë punëtore)
- Së dyti, parashikimet inflacioniste.

2.6.1 Kurba e Philips-it, marrëdhëniet ndërmjet inflacionit dhe papunësisë në afat të shkurtër


Kurba e Philipsit në periudhë afatshkurtët tregon lidhjet ekzistuese midis inflacionit dhe papunësisë në kushtet e një norme konstante të inflacionit të pritshëm dhe normës konstante natyrore të papunësisë.

Hulumtimet të cilat i kanë realizuar ekonomistët në tregjet ekonomike bashkëkohore sygjerojmë në atë se këto janë dy qëllime të cilat janë në kundërshtim. Nëse realizohet njëra, tjetra drejtohet në drejtim të kundërt. Gjegjësishtë, nëse në ekonomi realizohet qëllimi i punësimit të ulët, kjo do të paguhet me normë të lartë të inflacionit, dhe e kundërta, nëse mbahet normë e ulët e

inflacionit, kjo do të rrisë punësimet. Dmth ndërmjet normës së papunësisë dhe normës së inflacionit egziston një varshmëri e ndërjesshtë inverse i quajtur një lloj zëvendësimi inflacioni i ulët për papunësi të lartë dhe e kundërta. Profeshori anglez Philips në vitin 1958 i ka hulumtuar marrëdhëniet e normës së inflacionit dhe normës së papunësisë dhe e ka zbuluar kompromisin – shkëmbimin.

Figura na tregon se në 0% inflacion në ekonomi do të ketë 5,5% normë të papunësisë dhe e kundërta, në nivel prej 1% papunësi norma e inflacionit do të jetë 7,5%. Kurba e Philipsit tregon se shkalla më e lartë e inflacionit është e shoqëruar me shkallë më të ulët të papunësisë. Ajo sygjeron se do të mund të shkëmbejmë më shumë inflacion për më pak papunësi ose e kundërta.

Figura: 5 Kurba e Philips-it në afat të shkurtër



2.6.2 Kurba e Philips-it, marrëdhëniet ndërmjet inflacionit dhe papunësisë në afat të gjatë


Kurba e Philipsit në periudhë afatgjate ndryshon nga kurba afatshkurte, sepse këtu tregohet lidhja e inflacionit dhe papunësisë, kur norma e inflacionit aktual është e barabartë me normën e pritshme të inflacionit.

Sot numër i madhë i ekonomistëve përfaqësojnë këndvështrimin se marrëdhëniet e papunësisë dhe inflacionit janë të qëndrueshme vetëm në afat të shkurtër, përkatësisht kurba e Philips-it vlenë vetëm në afat të shkurtër. Në afat të gjatë nuk është kështu. Në figurën më poshtë është prezentuar lëvizja e papunësisë dhe inflacionit në SHBA në afat të gjatë. Këtu shihet se zhduket kurba e Philips dhe fitohet një kurbë shumë e pazhakonshme e cila lëviz në drejtim të shigjetave të ores, duke lëvizur për jashtë dhe për brenda.

Ndryshimet e kurbës së Philips-it në afat të gjatë sqarohen nëpërmjet normës natyrore të papunësisë.

Norma natyrore e papunësisë e jep tendencën afatgjate të normës së vërtetë të papunësisë dhe marrëdhëniet ndërmjet shkallës natyrore dhe të vërtetë të papunësisë janë të ngjajshme si marrëdhëniet ndërmjet PBB potenciale dhe PPB faktike.

Figura: 6 Kurba e Philips-it në afat të gjatë



Siç mund të vërejmë nga figura e mësipërme analiza kalon në 4 periudha.

Periudha e parë, kur ekonomia ndodhet në pikën A nuk pëson goditje as ne ofertë as në kërkesë, dhe papunësia është në normën natyrore të saj. Kjo i takon periudhës afatshkurte.

Periudha e dytë, pika B tregon periudhën e ekspansionit ekonomik e cila përcillet me rritjen e produktivitetit dhe uljen e papunësisë, sepse rritja e prodhimit kërkon më shumë forcë punëtpre. Pagat dhe çmimet fillojnë të rriten dhe inflacioni i pritshëm nuk ndryshon.

Periudha e tretë, këtë fazë e karakterizon rritja e normave të inflacionit të pritshëm. Agjendët ekonomik fillojnë ta parashikojnë inflacionin e lartë duke marrë parasysh atë në marrëveshjet që ata hartojnë me pagat e fuqisë çunëtore dhe çmimet e mallrave dhe shërbimeve. Kurba e Philipsit zhvendoset duke treguar se për çdo nivel të papunësisë, niveli i inflacionit është më i lartë (pika C), siç mund ta vërejmë në figurë, në Pikën B dhe C norma e papunësisë është e njejtë, por norma e inflacionit ndryshon.

Periudha e katërt, në këtë periudhë ekonomia ka ngadalësuar ritmin e zhvillimit duke kthyer nivelin e prodhimit në kufijt e tij potencial dhe normën e papunësisë e kthen në nivelin e saj natyror.

2.7 Ligji i Okun-it, mbi lidhjen e papunësisë dhe rritjes ekonomike

Kur bëhet fjalë për studimin e ekonomisë, rritja dhe vendet e punës janë faktorët kryesorë që ekonomistët duhet të marrin në konsideratë. Egziston një marrëdhënie e qartë midis tyre, dhe shumë ekonomistë e kanë hartuar diskutimin duke u përpjekur të studiojnë marrëdhëniet midis rritjes ekonomike dhe niveleve të papunësisë. Ekonomisti Arthur Okun filloi të merrej me diskutimin në vitet 1960 dhe kërkimi i tij mbi këtë temë është bërë i njohur si ligji i Okun-it. Ligji i Okun-it analizon marrëdhëniet midis papunësisë dhe rritjes ekonomike. Ligji i Okun-it thotë se produkti i brendshëm bruto (PBB) i një vendi duhet të rritet me një normë rreth 4% për një vitë për të arritur një ulje prej 1% të normës së papunësisë.

Marrëdhëniet negative midis shkallës së papunësisë dhe rritjes ekonomike u emërua me “Ligjin Okun” u emrua nga ekonomisti amerikan Arthur Okun, i cili vendosi një lidhje empirike midis këtyre parametrave në fillim të viteve 1960, sipas të cilit egziston një marrëdhënie e kundërt midis shkallës së papunësisë dhe PBB reale, duke treguar se një ulje e papunësisë me një pikë përqindje jep një rritje shtesë të PBB-së reale me rreth 2%. Prandaj, një rritje e nivelit aktualë të papunësisë me 1%, qon në zvogëlimin e PBB-së aktuale në krahasim me PBB-në reale me 2%.

Ligji i Okun-it analizon marrëdhëniet statistikore midis shkallës së papunësisë së një vendi dhe shkallës së rritjes ekonomike të tij. Kërkimet ekonomike të Bankës Federale të Rezervave, shpjegon se ligji i Okun-it ka për qëllim të na tregojë se sa nga prodhimi i brendshëm bruto (PBB) i një vendi mund të humbasë kur shkalla e papunësisë është mbi normën natyrore. Ai vazhdon të shpjegojë se logjika prapa ligjit të Okun-it është e thjeshtë. Prodhimi nvarret nga sasia e punës së përdorur në procesin e prodhimit, kështu që egziston një marrëdhënie pozitive midis prodhimit dhe punësimit. Punësimi total është i barabër me fuqinë punëtore minus të papunët, kështu egziston një marrëdhënie negative midis prodhimit dhe papunësisë.

Ligji i Okun-it në thelb është një rregull i pëtgjithshëm për të shpjeguar dhe analizuar marrëdhëniet midis vendeve të punës dhe rritjes ekonomike.

Ky rregull i përgjithshëm përshkruan marrëdhëniet midis ndryshimeve në normën e papunësisë dhe shkallës së rritjes së produktit të brendshëm bruto (PBB). Okun-i vuri në dukje se për shkak të rritjeve të vazhdueshme në madhësinë e fuqisë puntëre dhe në nivelin e produktivitetit, normalisht kërkohet rritja reale e PBB-së afër shkallës së rritjes së potencialit të saj, vetëm për të mbajtur nivelin e papunësisë. Për të ulur shkallën e papunësisë, ekonomia duhet të rritet me një ritëm mbi potencialin e saj.

Më konkretisht, sipas ligjit të Okun-it, për të arritur një rënie prej prej 1% të normës së papunësisë gjatë një viti, PBB-ja reale duhet të rritet afërishtë 2% më shpejtë se sa shkalla e rritjes së PBB-së potenciale gjatë asaj periudhe. Pra nëse shkalla e mundshme e rritjes së PBB-së është 2%, ligji i Okun-it thotë se PBB-ja duhet të rritet me rreth një normë 4% për një vit për të arritur një ulje prej 1% në shkallën e papunësisë.

Vlenë të theksohet se ligji i Okun-it shpreh një marrëdhënie statistikore të mbështetur në regresionin e papunësisë dhe rritjes ekonomike, si e tillë drejtimi i regresionit mund të rezultojë me koeficientë të ndryshëm që përdoren për të zgjedhur ndryshimin e papunësisë.

Ligji ka evoluar me kalimin e kohës për tju përshtatur klimës aktuale ekonomike dhe tendencave të punësimit. Një version i ligjit të Okun-it ka deklaruar shumë thjeshtë se kur papunësia bie me 1% produkti i brendshëm bruto (PBB) rritet 3%. Një version tjetër i ligjit të Okun-it përqëndrohet në një marrëdhënie midis papunësisë dhe PBB-së, ku nëse papunësia rritet me 1% shkakton një rënie prej 2% të PBB-së.


Analiza statistikore, në përputhje me kushtet e ekonomisë shqiptare dhe ato të vendeve të rajonit të përfshira në studime gjatë periudhës 2004-2019, tregon se ligji i Okun-it është i vlefshëm, por natyrishtë me një formë të veçantë. Për shembull, në Shqipëri zvogëlimi i papunësisë pritet të ndodh vetëm nëse norma e rritjes së PBB-së është mbi 4,39% dhe për çdo rritje 1%, më lartë 4,3%, shkalla e papunësisë pritet të ulet me 0,15%, në Maqedoninë e Veriut zvogëlimi i papunësisë pritet të ndodh vetëm nëse norma e rritjes së PBB-së është mbi 2,89% dhe për çdo rritje 1% më lart 2,89%, norma e papunësisë pritet të ulet me 0,45%. Në Malin e Zi, ulja e papunësisë pritet të ndodh vetëm nëse norma e rritjes së PBB-së është mbi 1,37%, dhe për çdo rritje % më lartë shkalla e papunësisë pritet të ulet me 0,459%. Ndërsa ulja e papunësisë në Serbi pritet të ndodh vetëm nëse norma e rritjes së PBB-së është mbi 3,87% dhe për çdo rritje 1% më lartë 3,87%, norma e papunësisë pritet të ulet me 0,775%.

3. ZHVILLIMET MAKROEKKONOMIKE NË VITIN 2019

3.1 PBB dhe inflacioni

Sipas të dhënave të fundit, në vitin 2019 ka pasur një përshpejtim të aktivitetit ekonomik, i cili arriti një normë reale të rritjes prej 3.6%, në krahasim me vitin 2018 që ishte 2.7%. Kjo rritje është pasqyrim i mjedisit të brendshëm i qëndrueshëm, pritjeve dhe besimit të qëndrueshëm të subjekteve ekonomike, performacës së favorshme në sektorin e eksportit, si dhe zhvillimeve të mëtejshme të favorshme në tregun e punës dhe zbatimit të projekteve kryesore të infrastrukturës publike.

Figura: 7 PBB dhe kërkesa efektive e huaj (normat reale vjetore të ndryshimit, në %)




Burimi: BPRM, Raporti vjetor i viti 2019, Shkup, Prill 2020

Shikuar nga ana e prodhimit, gjatë vitit 2019, shumica e aktiviteteve tregojnë rritje reale të vlerës së shtuar dhe rrjedhimisht kontribute pozitive në rritjen totale të PBB-së. Kështu, si në vitet e fundit, kontribut më të lartë pozitiv në rritjen ekonomike për vitin 2019 ka grupi i aktiviteteve “Tregtia, Transporti dhe Hoteleria”. Gjithashtu ngajshëm me vitin e kaluar, sektori industrial ka një kontribut të lartë pozitiv dhe u regjistrua me rritje reale të vlerës së shtuar prej 3.1%. Analizuar në mënyrë më të detajuar përmes indeksit të prodhimit industrial, rritja e industrisë është kryesisht rezultat i arritjeve të favorshme në industrinë përpunuese në lidhje me prodhimin në aktivitetet në të cilat ka kapacitet më të mëdha të eksporti me kapital të huaj, edhe sektori i energjisë ka një kontribut të rëndësishëm. Për më tepër sektori i ndërtimit në vitin 2019 regjistroi një normë solide të rritjes vjetore reale dhe rrjedhimisht një kontribut pozitiv në

rritjen e PBB-së, e cila është një përmisim kundrejt ecurive të pafavorshme dhe rënies së aktivitetit në këtë sektor gjatë vitit 2018. Përmisimet në sektorin e ndërtimit lidhen me rritjen në fushën e inxhinierisë në lidhje me zbatimin e mëtejshëm të projekteve kryesore të infrastrukturës publike, dhe një kontribut i rëndësishëm mund të shihet nga ndërtimet e larta.


Figura: 8 PBB (rritja reale në %) dhe përbërësit e shpenzimeve të PBB (kontributet në rritje)



Burimi: BPRM, Raporti vjetor i viti 2019, Shkup, Prill 2020

Bujqësia gjithashtu ka një kontribut pozitiv në rritjen e përgjithshme ekonomike, meqënëse rritja e vlerës së shtuar në këtë sektor po ngadalësohet krahasuar me rritjen në vitin 2018. Në shumicën e veprimtarive të mbetura në sektorin e shërbimeve, ka një rritje reale të vlerës së shtuar dhe si rrjedhojë një kontribut pozitiv në rritjen totale të PBB-së.

Figura: 9 Kontributet në rritje reale të PBB-së




Burimi: BPRM, Raporti vjetor i viti 2019, Shkup, Prill 2020

Për sa i përket të kërkesës agregate, rritja e ekonomisë së brendshme në vitin 2019 buron nga kërkesa e brendshme, ndërsa eksporti neto, e cila në dy vitet e kaluara ka kontribuar pozitivisht në rritje, në vitin 2019 ka një kontribut negativ. Rritja e kërkesës së brendshme u mbështet nga të gjithë përbërësit e saj. Kështu konsumi personal ka një kontribut të rëndësishëm pozitiv, në kushtet e rritjes së të ardhurave të disponueshme, lëvizjes së favorshme në tregun e punës dhe rritjes së mbështetjes së kredisë për popullsinë. Investimet në vitin 2019 u kthyen në zonën pozitive, pas dy vitesh rënie, e cila u shkaktua kryesisht nga pasiguria politike në atë periudhë dhe ndalja e përkohshme e investimeve të mëdha në infrastrukturën publike. Rritja e investimeve në vitin 2019 është në përputhje me rritjen e vërejtur në ndërtim dhe rritjen e importit të produkteve të investimeve. Konsumi publik gjithashtu ka dhënë një kontribut pozitiv në rritjen e ekonomisë së brendshme. Eksporet e mallrave dhe shërbimeve mbeten kategoritë që kushtëzojnë rritjen, me kontribut më të lartë individual pozitiv përkundër faktit që në vitin 2019 kishte një rritje të pasigurisë globale dhe një ngadalësim të rritjes së disa prej partnerëve kryesor të tregtisë. Strukturat e reja të prodhimit të orientuara drejt eksportit me kapital të huaj vazhdojnë të kontribuojnë më së shumti në arritjet e tilla të eksportit, dhe disa nga sektorët tradicionale të eksportit kanë kontribut shtesë. Rritja e eksporteve dhe rritja e kërkesës së brendshme çuan në rritjen e mallrave dhe shërbimeve të importuara, me të cilat eksportet neto dhanë një kontribut negativ në PBB-në.

Në vitin 2019 shkalla e inflacionit ishte 0.8%, e cila është një ngadalësim i rritjes së çmimeve krahasur me vitin 2018 (kur u regjistrua inflacion prej 1.5%). Ngadalësimi i inflacionit të


brendshëm është pasqyrim i ndryshimeve në tregjet botërore të produkteve primare të energjisë dhe efektet indirekte të tyre në çmimet e tjera. Inflacioni bazë gjithashtu ka kontribut në ngadalësimin e rritjes mesatare të çmimeve, kryesisht për shkak të rënies së çmimeve për disa shërbime të transportit. Analizuar në mënyrë dinamike, rritja e çmimeve të konsumit ngadalësohet vezhdimisht, nga 1.2% në tremujorin e parë në 0% në tremujorin e fundit të vitit. Në vitin 2019, hendeku i prodhimit ishte më pak pozitiv, duke treguar mungesën e presioneve të çmimeve nga rritja e kërkesës së brendshme.

Figura: 10 Inflacioni i brendshëm dhe inflacioni efektiv i huaj, ritmet e rritjes vjetore në %



Burimi: BPRM, Raporti vjetor i viti 2019, Shkup, Prill 2020

Figura: 11 Ndryshimi (ushqim dhe energji) dhe përbërësit afatgjatë të inflacionit




Burimi: BPRM, Raporti vjetor i viti 2019, Shkup, Prill 2020

Për sa i përket përbërësve kryesorë të indeksit të çmimit të kosumit, përbërësi i ushqimit kishte kontribut më të lartë pozitiv në rritjen vjetore (ritje prej 1.9% dhe kontribut prej 0.7 pp inflacion total), duke reflektuar kryesisht çmimet më të larta të perimeve, si p.sh dhe rritjen e çmimeve të bukës dhe drithërave. Një kontribut pozitiv shtesë në rritjen e çmimeve të konsumit ka përbërësin thelbësore (rritje prej 0.5% dhe kontribut prej 0.3 pp në inflacionin total), e cila i detyrohet pjesërisht një rritjeje të çmimeve të duhanit, në të njëjtën kohë edhe më e thksuar presionet nga rënia e çmimeve të veshjeve, këpcëve dhe shërbimeve të transportit ajror. Nga ana tjetër, përbërësi i energjisë ka një kontribut të vogël negative në rritjen vjetore të çmimeve të brendshme (rënie prej 1.1% dhe një kontribut prej -0.2 pp në inflacionin total), kryesisht për shkak të uljes së çmimeve të brendshme të derivative të naftës, në përputhje me lëvizjen e çmimeve të naftës në tregjet botërore, dhe në një masë më të vogël uljen e çmimeve të energjisë termike.

3.2 Tregu i punës

Në përputhje me zhvillimet pozitive në ekonomi, në vitin 2019 shumica e treguesve të tregut të punës tregojnë për vazhdimin e tendencave të favorshme. Në të njejtën kohë, gjatë vitit 2019, zbatimi i masave aktive të punësimit vazhdoi, si mbështetje shtesë për rritjen e punësimit. Numri i të punësuarve në vitin 2019 u rrit me 5.1%, që është një përshpejtim krahasuar me rritjen në vitin 2018. Në të njejtën kohë shkalla e punësimit u rrit me 2.2 pikë përqindje, dhe ishte 43.7%. Analizuar nga sektorët, në vitin 2019, rritja e punësimit lidhet kryesisht me sektorin e shërbimeve, duke reflektuar kryesisht zhvillime pozitive në “veprimtarit e shërbimit administrative”, aktivitetet “arte, argëtim dhe rekreacion”, si dhe në “transport dhe magazinim”. Industria gjithashtu jep një kontribut të rëndësishëm, duke reflektuar kryesisht zhvillimet pozitive në industrinë e prodhimit. Nga ana tjetër, numri i njerëzve të punësuar në bujqësi në vitin 2019 vazhdon të bjerë.

Figura: 12 Treguesit e zgjedhur të punës




Burimi: BPRM, Raporti vjetor i viti 2019, Shkup, Prill 2020

Zhvillimet të favorshme gjatë vitit 2019 janë vërejtur edhe nga ana e fuqisë punëtore. Gjegjësishtë, popullsia totale aktive u rrit me 0.7%, e cila gjatë një rënie të njëkohshme të 2 popullsisë joaktive me 0.6% çoni në një zhvendosje të lartë të aktivitetit të popullsisë me 0.3 pikë përqindje, e cila ishte 57.2%. Zhvillimet pozitive, si nga ana e kërkesës edhe nga ana e ofrës për punë, kontribuan në uljen e papunësisë, në vitin 2019 norma e papunësisë u zvogëlua me një rënie historike prej 17.3%, me rënie vjetore prej 3.5 p.p.

Ulja e nivelit të përgjithshëm të papunësisë shpjegohet me papunësinë më të ulët midis të gjitha grupeve të moshës, me një rënie të dukshme të vërejtur tek të rinjtë e moshës 15 deri 24 vjeç. Rritja e pagave mesatare vazhdoi në 2019, e cila pjesërisht është për shkak të rritjes së nivelit të


pagës minimale neto. Kështu pagat minimale neto dhe bruto regjistruan rritje vjetore prej 3.9% dhe 5.2%. rritje e pagave neto u regjistrua pothuajse në të gjithë sektorët, veçanërisht rritje e lartë u regjistrua në shëndetësi dhe shërbimet sociale me 9.4%, aktivitetet e transportit kishin rritje prej 8.6%, në ndërtim me 6.2%, në shërbimet administrative me 5.9%, buqësi me 5.6%, industria me 5.4%. Në nivelin e përgjithshëm të çmimeve të konsumit, pagat neto dhe bruto regjistruan rritje reale prej 3.1% dhe 4.3%.

Figura: 13 Shkalla e papunësis sipas grupeve të moshës në %



Burimi: BPRM, Raporti vjetor i viti 2019, Shkup, Prill 2020

Figura: 14 Pagat mesatare bruto dhe neto, ndryshimet vjetore në %



Burimi: BPRM, Raporti vjetor i viti 2019, Shkup, Prill 2020

3.3 Papunësia në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Nga panvarësia e deri më sot, Republika e Maqedonisë së Veriut ka vazhdimisht nivele të larta të papunësisë, pra midis niveleve më të larta të papunësisë në Evropë. Edhe para panvarësisë, Maqedonia kishte nivele të larta të papunësisë, dmth në vitin 1975 shkalla e papunësisë ishte 22,4%, në vitin 1985 ishte 21,82%, në vitin 1990 shkalla e papunësisë ishte 23,55%. Sidoqoftë, një rritje drastike e papunësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut është gjatë procesit të privatizimit, dmth në vitin 1995 është regjistruar një normë e papunësisë prej 35,6%. Ndryshimi i pronësisë nga pronësia publike apo shtetërore në pronësi private priste të rriste investimet dhe të ulte papunësinë por ndodhi e kundërta. Gjatë kësaj periudhe, Republika e Maqedonisë së Veriut regjistroi nivele mjaftë të larta të papunësisë.

Tabela: 1 Norma e papunësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (1997-2019).

Normat e Papunësisë											
Vitet	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
%	36	34,5	32,4	32,20	30,52	31,94	36,69	37,16	37,25	36,03	34,93

Normat e Papunësisë												
Vitet	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
%	33,76	32,18	32,02	31,38,	31,08	29,00	28,00	26,07	23,72	22,38	20,74	17,76

Burimi: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut 2020

Nga tabela mund të shohim se shkalla e papunësisë në periudhën e tranzicionit regjistrojë nivele të larta të papunësisë, dmth në vitin 1997 norma e papunësisë ishte 36%, në vitin 1998 kemi një rënie të lehtë të shkallës së papunësisë me 1,5% dhe arrin në 34,5%. Në periudhën tjetër përsëri është ulur norma e papunësisë në 32% kështu që në vitin 2001 kemi një normë të papunësisë prej 30,52% që është niveli më i ulët i papunësisë që nga panvarësia. Në periudhën që pas vitit 2001, për shkak të konfliktit ushtarak, përkatësisht luftës civile në Maqedoni, ajo ndikoi në aktivitetin ekonomik në Maqedoni, dmth aktiviteti ekonomik u zvogëlua ndjeshëm në atë periudhë. Për shkak të kësaj, është rritur norma e papunësisë në këtë periudhë në Maqedoninë e Veriut. Kjo është arsyeja pse në atë periudhë të pasluftës kemi pasur rritje të mprehtë të normës së papunësisë dhe në viteti në vijim gjithçka varijonte nga 36%.

Një fenomen vlen të theksohet se në periudhën pas konfliktit ushtarak ekonomia e Maqedonisë së Veriut arriti nivele të larta të rrites ekonomike, dmth në vitin 2003 norma e rritjes ishte 2,22% dhe papunësia u rrit me 4,8%, në vitin 2004 shkalla e rritjes së PBB-së ishte 4,67% dhe papunësia u rrit me 0,5% në 37,16%. Në vitin 2005 kemi një normë të rritjes ekonomike prej 4.72% dhe papunësia u rrit përsëri minimalisht në 37,25%. Mund të shohim se në këtë periudhë për shkak të faktit se kemi një normë të lartë të rritjes së PBB-së, shkalla e papunësisë është akoma në rritje. Nga ana tjetër mund të shohim se gjatë krizës ekonomike globale dhe krizës evropiane (2009-2013) janë regjistruar norma të ulëta të rritjes, në vitin 2009 dhe në vitin 2012

janë regjistruar madje norma negative të rritjes ekonomike. Gjithashtu në këtë periudhë kemi një rënie të vazhdueshme të shkallës së papunësis në 32,18% në vitin 2009 dhe në 29,0% në vitin 2013. Ky është një fenomen mjaft i pazakontë në ekonomi. Sidoqoftë kjo është për shkak të politikave të ndryshme të zbatuara nga qeveria, për shkak të ndyshimit të disa ligjeve etj,

Tabela: 2 Normat e PBB-së reale në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2000-2019)

Normat e PBB-së reale										
Vitet	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
PBB(%)	4.55	3.07	1.49	2.22	4.67	4.72	5.14	6.47	5.47	-0.36

Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
PBB(%)	3.36	2.34	-0.46	2.93	3.63	3.86	2.85	1.08	2.72	3.55

Burimi: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut 2020

Numri i të punësuarve në vitin 2014 u rrit me 1,7%. Rritje kjo më e vogël në krahasim me vitin e kaluar. Popullsia e përgjithshme aktive regjistroi rritje prej 0,3%, që do të thotë në të njëjtën kohë një ulje e vogël në popullsinë joaktive, që pozicionoi gjithashtu një rritje të vogël të normës së aktivitetit në 57,3%. Si pasojë në vitin 2014 norma mesatare e papunësisë ishte 28.03%, ndërsa norma e punësimit u rrit në 40,22%. Sa i përket strukturës së punësimit sipas grupmoshave pjesa më e rëndësishme e papunësisë i takon popullsisë prej moshës 25 deri 49 vjeç, moshës së plakur e cila përbën mbi 60% të numrit të përgjithshëm të të papunëve. Duke pasur parasush që mbi 80% e të papunëve të kësaj grupmoshe janë të papunë afatgjatë, këto zhvillime tregojnë për një reduktim të mundshë, në papunësin afatgjatë.

Numri i të punësuarve në kuartalin e kaltërt të viti 2015 është 2,8% më i lartë në krahasim me të njëjtë periudhë të vitit të kaluar, ndërsa numri i të papunëve është i ulur me 11,9% e cilë rezultoi në uljen e normës së papunësisë në kuartalin e fundit të vitit 2015 në 26,07%.

Norma e papunësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2013 ka qënë 29,00% e cila ka shënuar rënie në krahasim me vitin 2012 që ka qënë 29,89%, një rënie prej gati 1%. Në vitin 2014 gjithashtu ka shënuar rënie prej 1% dhe është 28,03%.

Gjithashtu rënie të konideruar ka edhe në vitin 2015 me 26,07% krahasuar me vitin 2014. Në vitin 2016 ka rënie prej 23,72%, gjithashtu në vitin 2017 kemi rënie prej 22,38%

Në vitin 2018 kemi rënie të normës së papunësisë me 20,74%. Në vitin 2019 kemi rënie të konsideruar të normës së papunësis me 17,76% në krahasim me vitin 2018.

3.3.1 Papunësia sipas gjinisë

Analiza e papunësisë sipas gjinisë tregon se papunësia midis meshkujve dhe femra është pothuajse e barabartë, dmth egziston një ndryshim i vogël midis normës së papunësisë midis meshkujve dhe femrave. Mund të shohim se norma e papunësisë tek meshkujt është më e ulët se norma e papunësisë për femrat përveç në vitet 2011, 2012, ku norma e papunësisë është më e ulët për femrat dhe në vitin 2012 kemi të njejtën normë të papunësisë.

Tabela 3: Normat e aktivitetit të popullsisë, punësimit dhe papunësisë sipas gjinisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2004-2019).

Vitet	Norma e aktivitetit %	Norma e aktivitetit % femra	Norma e aktivitetit % meshkuj	Norma e punësimit %	Norma e punësimit % meshkuj	Norma e punësimit % femra	Norma e papunësisë %	Norma e papunësisë % femra	Norma e papunësisë % meshkuj
2000	52.9	40.92	64.4	36.05	45.55	30.00	32.20	34.9	30.5
2001	55.5	41.31	65.6	37.02	46.07	30.94	30.52	32.06	29.54
2002	52.64	41.71	63.68	36.35	44.56	28.07	31.94	32.3	31.7
2003	54.51	42.53	65.57	34.06	41.10	27.65	36.69	36.28	36.96
2004	54.61	42.29	65.6	33.85	41.50	28.60	37.16	37.81	36.74
2005	56.7	42.05	65.96	33.83	41.89	35.08	37.25	38.44	36.48
2006	54.01	41.85	66.23	34.53	42.89	36.32	36.03	37.2	35.27
2007	54.51	42.87	66.14	35.42	43.32	27.70	34.93	35.54	34.53
2008	56.3	42.59	67.61	36.45	44.98	28.12	33.76	34.16	33.51
2009	56.7	42.46	68.45	37.57	46.73	28.62	32.18	32.82	31.78
2010	56.9	42.79	68.57	37.81	46.75	29.07	32.02	32.24	31.88
2011	56.8	43.44	67.55	38.06	46.16	30.11	31.38	30.79	31.76
2012	56.5	43.01	67.40	38.62	46.19	29.98	31.02	30.33	31.46
2013	57.2	44.37	67.28	39.58	47.28	31.58	29.00	29.62	38.98
2014	57.3	43.92	67.96	40.22	49.20	31.04	28.03	28.62	27.65
2015	57.5	43.53	67.41	41.04	49.57	32.56	26.07	25.06	26.72
2016	54.88	42.35	67.57	41.93	51.25	32.69	23.72	22.73	24.36
2017	55.13	42.72	67.66	42.81	52.35	33.4	22.38	21.82	22.74
2018	55.15	43.01	67.46	43.75	53.14	34.48	20.74	19.87	21.3
2019	55.46	42.0	66.10	45.30	55.07	36.67	17.76	17.05	18.22

Burimi: Enti Statistikor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Raporti vjetor 2020

Gjithashtu mund të shohim se shkalla e papunësisë për të dy gjinitë është në rënie të vazhdueshme me intensitet të ngjajshëm, kështu që në vitin 2004 norma e papunësisë për meshkujtë është 36,74% dhe zvogëlohet në vitin 2014 që është 27,65% ose është ulur me 9,1%. Ndërsa për gratë në vitin 2004 norma e papunësisë është 37,81% dhe zvogëlohet, dhe në vitin 2014 norma e papunësisë është 28,62% që është një rënie prej 9,2% për këtë periudhë. Mund të shohim se në këtë periudhë prej 10 viteve papunësia e të dy gjinive ka rënë pothuajse identikisht me 0,1% më shumë niveli i papunësisë së grave ka rënë.

Në periudhën 2004 – 2019, normat e aktivitetit, punësimit dhe papunësisë, shënojnë ndryshime minimale nga viti në vit. Në këto katër vite norma e aktivitetit është pothuasje në nivelin e njëjtë, përkatësisht 56,8% në vitin 2011 është 56,8%, në vitin 2012 është 56,5% , në vitin 2013 dhe në vitin 2014 është 57,3%. Norma më e lartë e punësimit prej 45,30% është regjistruar në vitin 2019, ndërkohë që norma më e ulët e papunësisë prej 17.76% është regjistruar gjithashtu në vitin 2019.

Struktura e të punësuarve sipas gjinisë ka rëndësi të shumëfishtë në një ekonomi nacionale. Punësimi i gjinis femërore ndikon në përmisimin e bazës materiale të familjes, ndikon në ndryshimin e botëkuptimeve në aspektin pozitiv, ngre vlerën e gjinis femërore në shoqëri si dhe ndikon në ngritjen e nivelit të edukimit të femijëve.

Gjatë këtyre viteve të fundit norma e papunësisë ka pasur një rënie të vazhdueshme në vitin 2016 norma e papunësië tek meshkujt ka rënë në 24.36% krahasuar me vitin 2015 që ka qënë 26,72% dhe ka një rënie prej rreth 2%. Gjithashtu në vitin 2017 norma e papunësisë ka qënë 22,38% dhe ka rënie prej rreth 2% nga viti 2016, në vitin 2018 norma e papunësië ka rënë prap rreth 2% ku ka qënë 20.74% nga viti paraparak, dhe në vitin 2019 norma e papunësisë ka rënë në 17,76%.

Egziston një hendek i madh gjinor midis shkallës së aktivitetit të meshkujve dhe femrave. Shkalla e aktivitetit të meshkujve krahasuar me vendet në Evropë është afërsisht e barabrtë me normën mesatare të aktivitetit të atyre vendeve. Sidoqoftë, niveli i aktivitetit tek femrat është më i ulët, kështu që hendeku gjinor është dukshëm më i madh në Maqedoni se sa në vendet evropiane.

Nga tabela nivelet e aktivitetit për meshkuj dhe femra, mund të shohim se niveli i aktivitetit për femrat është shumë më i ulët se niveli i aktivitetit për meshkujt. Kjo do të thotë se femrat marrin pjesë më pak në prodhimin e brendshëm bruto dmth do të thotë se femrat si burim njerëzor përdoren më pak se meshkujt. Mund të shohim se shkalla e aktivitetit rritet në të dy gjinitë, kështu që shkalla e aktivitetit për meshkujt në periudhë prej 10 vjetëve u rrit me 5,8%, dmth nga 65,6% në vitin 2004 u rrit në 67,96% në vitin 2014. Norma e aktivitetit midis femrave në periudhën prej 10 vjetëve u rrit me 4,4% dmth nga 42,29% në vitin 2004, në 43,92% në vitin 2014.

Norma e aktivitetit tek meshkujt gjithashtu është rritur edhe gjatë këtyre viteve të fundit, në vitin 2015 është rritur me 67,41% edhe gjatë viteve tjera ka pasur rritje, në vitin 2019 norma e papunësisë tek meshkujt është rritur në 66,10%. Edhe tek femrat norma e aktivitetit ka pasur rritje në vitin 2015 norma e aktivitetit ka qënë 43,53%, edhe në vitet në vazhdimsi ka pasur rritje të normës së aktivitetit në vitin 2019 norma e aktivitetit ka qënë 42,0%.

Nga tabela mund të shohim që shkalla e punësimit është dukshëm e ulët. Sidoqoftë, mund të vërejmë gjithashtu se ndryshe nga viti 2004 shkalla e punësimit ishte 33,85%, në vitin 2014 është rritur në 40,22%, në të dy gjinit kemi rritje të shkallës së punësimit, kështu që në vitin 2014 shkalla e punësimit për meshkujt është e lartë dhe ka qënë 49,20% ndërsa norma e punësimit në

mesin e femrave gjithashtu ka një rritje të qëndrueshme dhe në vitin 2014 ishte 31,04%. Gjithashtu edhe në vitet në vazhdimësi norma e punësimit tek meshkujt ka pasur rritje në vitin 2016 ka qënë 51,25%, në vitin 2018 ka pasur rritje dhe norma e punësimit ka qënë 53,14% dhe në vitin 2019 është rritur në 55,07%. Edhe tek femrat ka pasur rritje të punësimit në vitin 2016 norma e punësimit ka qënë 32,69%, në vitin 2017 gjithashtu ka pasur rritje prej rreth 2% dhe në vitin 2017 norma e punësimit ka qënë 33,4% edhe ne vitin 2019 ka pasur rritje prej rreth 2% dhe norma e punësimit ka qënë 36,67%.

Egzistojnë disa arsye për aktivitet dhe punësim më të ulët mes meshkujve dhe femrave. Arsyt kryesore të dhëna për pasivitetin midis femrave janë roli tradicionale i grave dhe niveli i arsimit. Kohët e fundit, megjithatë ka pasur rritjet të femrave që regjistrohen në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve. Roli tradicional i grave është ndoshta arsyeja më e rëndësishme për aktivitetin e ulët dhe punësimin e femrave.

3.3.2 Papunësia sipas nivelit të edukimit

Struktura e të papunëve, sipas nivelit të edukimit ka rëndësi të veçantë për ekonominë e një vendi, sepse ata paraqesin potencialin e ardhshëm të punës. Vendet që kanë të papunë të kualifikuar ndodhen në pozitë më të mirë sesa vendet që kanë norma të larta te papunësisë dhe të papunë të pakualifikuar.

Tabela 4: Struktura e papunësisë sipas nivelit të edukimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2016/2017).

Popillsia active sipas nivelit të edukimit												
	Popullsi active]të punësuar				Të papunësuar			
	II 2016	II2016	II2017	II2017	II 2016	II2016	II 2017	II 2017	II2016	II2016	II2017	II2017
Gjithësej	948.377	100%	955.699	100%	720.674	100%	739.892	100%	227.702	100%	215.807	100%
Arsim fillor	181.293	19%	158.569	17%	123.520	17%	117.744	16%	57.773	25%	40.824	19%
Arsim të mesëm	427.471	45%	468.363	49%	327.931	46%	354.960	48%	99.540	44%	113.403	53%
Arsim të lartë	216.614	32%	225.535	24%	170.947	24%	181.670	25%	45.667	20%	43.865	20%
Gjithsej meshkuj	587.825	62%	583.795	61%	443.920	62%	450.028	61%	143.905	63%	133.766	62%
Arsim fillor	127.823	13%	108.146	11%	84.195	12%	75.593	10%	43.629	19%	32.552	15%
Arsim të mesëm	275.868	29%	300.169	31%	211.144	29%	226.452	31%	64.724	28%	73.717	34%
Arsim të lartë	104.432	11%	105.871	11%	54.188	12%	90.635	12%	20.244	9%	15.236	7%
Gjithësej femra	360.552	38%	371.904	39%	276.755	38%	289.864	39%	83.797	37%	82.041	38%
Arsim fillor	53.469	6%	50.423	5%	39.325	5%	42.151	6%	14.144	6%	8.272	4%
Arsim të mesëm	151.602	16%	168.194	18%	116.787	16%	128.508	17%	34.815	15%	39.686	18%
Arsim të lartë	112.182	12%	119.665	13%	86.759	12%	91.036	12%	25.423	11%	28.629	13%

Burimi: Enti Statistikor i Reppublikës së Maqedonisë së Veriut, Raporti Vjetor 2018

Struktura e papunësisë sipas nivelit të edukimit nuk është e favorshme, sespe në tremujorin e dytë të vitit 2016 dhe tremujorin e dytë të vitit 2017 marrë në përqindje prej 63% dhe 62% tek meshkujt të papunë, norma më të larta ka tek meshkujt me arsim të mesëm dhe fillor. Gjithashtu kemi norma të larta edhe tek femra në tremujorin e dytë të vitit 2013 dhe tremujorin e dytë të vitit 2017 me 37% dhe 38%, ku përqindje me të madhe tek grat me arsim të mesëm. Kualifikimet e pamjaftueshme, mungesa e tregut të punës, si dhe struktura e moshës, vështirësojnë në masë të madhe inkuadrimit të kësaj kategorie të të papunëve si konkurrues aktiv në tregun e punës.

3.4 Inflacioni në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Përpos problemit të papunësisë, politika makroekonomike, gjithashtu vëmendje të posaçme i kushton edhe një problemi të rëndësishëm të cilin e ka vendosur si qëllim të vetin, dhe kjo është inflacioni. Ajo konsiderohet si sëmundje moderne në ekonominë bashkëkohore. Egziston në të gjitha shtetet: si ato të zhvilluara, të pa zhvilluara, në tranzicion.

Inflacioni është dukuri e rënies së vlerës së brendshme të parave dhe ngritjen e nivelit të brendshëm të çmimeve. Kjo është gjendje në ekonomi kur fondet e pagimit i tejaklojnë fondet e mallrave.

Pra siç thamë se inflacioni është rritja e sasisë së parave në ekonomi, me çka zvogëlohet fuqia blerëse e parave. Prej atje burojnë të gjitha përpjekjet dhe lufta e cila bëhet për tu ndaluar e njejtja, duke i pasur parasyshë problemet të cilat i bart me vete. Inflacioni është dukuri e cila është karakteristikë për të gjitha tregjet ekonomike bashkëkohore, po edhe për tonën. Në disa tregje ekonomike, gjithashtu, ajo ka vlera të ulëta në përqindje dhe në atë mënyrë vepron edhe si stimul, por në ekonomi të caktuara ka përqindje shumë të larta, dhe bëhet problem themelor i vështirë për shtetin.

Pas panvarësisë në vitin 1991 Maqedonia e Veriut ishte ballafaquar me rënie të shpejtë të prodhimit, me inflacion, zvogëlim të rëndësishëm të investimeve dhe me shkëmbim tregtar ndërkombëtar të zvogëluar. Në të njëjtën kohë, norma e papunësisë arriti 20% nga fuqia e përgjithshme punëtore për vitin 1994. Pas panvarsimit, shkalla e zhvillimit ishte negative dhe regresi vjetor (zvogëlimi) ishte më shumë se 10%. Në atë periudhë qeveria instaloi program të fuqishëm për stabilizim dhe reforma, me qëllim që të kontrolloj inflacionin. Të zvogëloj deficitin dhe të përforcojë ekonominë. Lufta në rajon, embargoja ndërkombëtare, si dhe bllokada e kufirit, kishin ndikim negativ mbi reformën në shtet. Edhe përpos këtyre pengesave, pas pothuajse pesë vjetë tranzicion, ekonomia në vitin 1996 filloi të lëvizë në drejtim të sipërm. Kjo ishte mbështetur nga projektet e Bankës Botërore për rritjen e BPV për rreth 5% në periudhën 1997-2001.


Sipas Entit Shtetëror për Statistikë, Maqedonia e Veriut e përfundon vitin 1998 me normë mesatare të inflacionit prej 0,8% që do të thotë se çmimet me pakicë të prodhimeve në vitin 1998 mesatarisht janë rritur për më pak se 1% përkundër 5% të planifikuara. Dallimi prej 4% sipas teoricientëve ekonomik, ka të bëjë me rënien e pa parashikuar të çmimeve të prodhimeve bujqësore, që kryesisht lidhet me tregun kosovar të mbyllur dhe marrëdhëniet të pa rregulluara funksionale me BE-në. Gjatë kësaj, pjesë e ndikimeve për inflacion të ulët kërkohet edhe në pagat e ngrira të shfrytëzuesbe buxhetor. Me inflacion të këtill Maqedonia e Veriut është në vend të parë në mesin e shteteve në tranzicion, me inflacion më të ulët. Norma vjetore prej 0,8%, përndryshe është norma më e ulët të cilën Maqedonia e Veriut e ka realizuar në shtatë vite, përkatësisht për periudhën post komuniste. Kështu në vitin kur është panvarësuar Maqedonia e Veriut ka pasur inflacion prej 1,79% në vitin 1991.

Tabela: 5 Norma e inflacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2000-2019)

Normat e inflacionit										
Vitet	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
%	6.61	5.20	2.31	0.86	-0.45	0.53	3.21	2.25	8.33	-0.74
Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
%	1.51	3.90	3.32	2.79	-0.28	-0.30	-0.24	1.35	1.46	0.77

Burimi: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Figura: 16 Norma e inflacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (1994-2021)



Burimi: Banka Popullore e Maqedonisë së Veriut, 2020

Edhe pse rritja e shpenzimeve për jetë filloi të shënojë një relaksim të caktuar në muajt e verës, megjithatë, në gusht të vitit 2008 aj akoma ishte i lartë me 8,6% në raport me vitin e kaluar. Për këtë shkak, shkalla e projektuar për vitin 2009 nga 3% fillestaret të projektuara në rreth 6% në nivel vjetor. Sa u përket shkaqeve për këto norma të larta të inflacionit, deri në 71% nga rritja e shpenzimeve për jetë është rezultat i rritjes së çmimeve të ushqimt. Edhe pse rritja e çmimeve të ushqimit është tendencë botërore, megjithatë ky problem në Maqedoninë e Veriut është dukshëm serioz, për shkak se në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si shtet në zhvillim, shpenzimet për ushqim marrin pjesë me përqindje të lartë në shpenzimet e përgjithshme për jetën e populates sesa shtetet tjera, si dhe shtetet në zhvillim. Në shtetet e zhvilluara kjo pjesëmarrje lëviz prej 10% deri 15%, në shtetet në zhvillim deri më 30%, ndërsa në Republikën e Maqedonisë së Veriut rreth 38%. Prej këtu, rritja e çmimeve të ushqimit drejtëpërdrejtë ndikon mbi rritjen e shpenzimeve për jetë dhe mbi zvogëlimin e standartit jetësor të populates. Përveç ushqimit shpenzimet e jetës rriten dhe për shkak të rritjes së çmimeve të prodhimeve tjera të nevojshme për jetë, si lëndët djegëse (36,1%), ngrohja qendrore (71,1%), shërbimet shëndetësore (20%) etj.

Në të njejtën kohë, shpezimi mujor i shportës i cili i përfshin vetëm artikujt ushqimor minimal për familje me katër antarë prej 12.333 denarë (mare 2008) merr pothuajse 80% të pages mesatare. Familjes i ngelin vetëm 3.426 denarë në muaj për kënaqjen e nevojave tjera, si shëndetësi, veshje, këpucë, higjienë, culture, argëtim dhe të ngajshme. Problem plotësues paraqet shpërndarja jo e barabartë e të ardhurave në shtet e cila e thëllon nyjën nëpërmjet shtresave shoqërore. Si rezultat i kësaj, rritja e barabrtë e pagave, p.sh do to thotë të ardhurat jot ë barabarta në shumë absolute. P.sh rritja për 3% e pages prej 6.000 denarë do të thotë rritje prej 180 denarë në muaj, ndërsa paga prej 15.000 denarë do të thotë 450 denarë në muaj.

Presion plotësues mbi inflacionin (sipas vlerësimeve të BPRM dhe të Misionit të FMN-së në RM) bëri edhe rritja e pensioneve edhe të pagave në administratën publike, nëpërmjet ndikimeve të këtyre rritjeve mbi rritjen e kërkesës.

Ndikimi negative it ë gjitha këtyre lëvizjeve mbi standartin jetësor të qytetarëve, në një mënyrë, zbutet me zmadhimin e ngarkimin e borxh të populates te bankat në shtet. Me të prekur nga këtë lëvizje të inflacionit, përkatësishtë nga rritja e çmimeve të ushqimit dhe të lëndëve djegëse, janë personat e varfër, personat e papunë të cilët pranojnë ndihmë sociale.

Me thellimin e krizës ekonomike botërore dhe problmet të cilat is jell ajo, në vitin2008 dhe në vitin 2009 në ekonominë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjithashtu u rritën problemet, u rrit shkalla e inflacionit dhe sektori real i zvogloi aktivitetet e veta. Me qëllim të zbuten pasojat nga inflacioni, por edhe ai zvogëlphet, BPRM në vitin 2009 ndërmoi një sere masa, para se gjithash zvogëlimin e të ashtuquajturit inflacion bazik (i cili në vitin 2009 ishte 2,8%) nëpërmjet kufizimit të rritjes së kredive bankare dhe nëpërmjet tërheqjes së kapitqlit të lire tepricë të ankave.

Nga tabela shohim që norma e inflacionit në vitin 2010 merr përsipër vlera pozitive në 1,6% dhe në vitin 2011 dhe 2012 norma arrin mbi 3%.

Në tremujorin e fundit të vitin 2013, çmimet e konsumit në vend shënuan rritje minimale prej 0,1%, pas rënies tremujore prej 0,7% në tremujorin e mëparshëm. Norma vjetore e inflacionit ngadalësohet dukshëm edhe më tej në tremujorin e fundit të vitit 2013, duke u reduktuar në nivelin e 1,3%, si pasqyrim i bazës më të lartë krahasuese të çmimeve të ushqimeve dhe të energjisë. Rritja vjetore edhe në vazhdim rrjedh nga komponentët ushqimor dhe komponentët afatgjatë të inflacionit, ndërsa ngadalësimi në masë të madhe është pasojë e rritjes së ngadalësuar në mënyrë të konsideruar të çmimeve të ushqimeve.

Komponenti afatgjatë i inflacionit, po ashtu shënon ngadalësim në terma vjetor, por edhe më tej është relativisht i lartë edhe më tutje, ndryshimet në këtë komponentë shpjegohen me ndikimi e faktorëve të përkohshëm, por edhe me efete të caktuara të transferuara nga rritja e mëparshme e çmimeve të ushqimit dhe të energjisë. Paralelishtë me ngadalësimin e inflacionit vendor, ngadalësimi i fuqishëm vjetor është vërejtur edhe tek inflacioni efektiv i huaj. Çmimet prodhuese të prodhimeve industriale vijojnë të ulen në terma tremujorë dhe në terma vjetorë.

Norma vjetore e inflacionit në dhjetorë të vitit 2014, e llogaritur sipas Indeksit të çmimeve të konsumatorit, shënon -0,5%. Norma mesatare e inflacionit për vitin 2014 shënon -0,3%, në krahasim me normën 2,8% që ishte në vitin 2013. Në nivel vjetor, kategoria e ushqimit dhe pije joalkoolike, e cila përbën pjesën më të madhe në Indeksin e çmimeve të konsumatorit, pati ulje prej 0,1%. Ulja e çmimeve vërehet edhe në kategorinë: Transport prej 7,2%, Rekreacione dhe kulturë 5,5%, Komunikim prej 2,5%, Mobilje, paisje dhe mirëmbajtje shtëpiake prej 2,3% dhe Restorante dhe hotele prej 0,2%.

Norma e inflacionit, e matur sipas indeksit të çmimeve të konsumatorit në kuartalin e fundit të vitit 2015, shënon ulje prej 0,4% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Në vitin 2016 për të tretin vitë me rradhë inflacioni qëndroi në zonën negative që në mungesë të presioneve më të konsiderueshme nga ana e kërkesës, reflekton ambient global të çmimeve përgjithësisht të ulura importuese të ushqimit dhe energjisë. Krahas kësaj gjatë tërë viti 2016 niveli i përgjithshëm i çmimeve shënoi rënie vjetore prej 0,2% që paraqet ngadalësim minimal të rënies së nivelit çmimeve në krahasim me dy vitet paraprake. Analiza dinamike tregon se çmimet e konsumit gjatë tërë vitit qëndruan në zonën negative.

Shkalla e inflacionit në gjysmën e dytë të viti 2019 ishte 1,2% që ishte nën pritshmërit. Rritja e çmimeve konsumatore në gjysmën e parë të vitit ishte si rezultat i rritjes së çmimeve të prodhimeve ushqimore 2,4%. Dinamika tremujore tregoi rritje të balancuar të çmimeve në të dy tremujoret bë gjysmën e parë të viti.

3.5 Politikat E Tregut Të Punës Në Maqedoninë E Veriut

Korniza e politikave të punësimit në Republikën e Maqedonisë përcaktohet nga Programi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Programi për Reformën e Punësimit dhe Politikës Sociale 2020, Strategjia Kombëtare e Punësimit e Republikës së Maqedonisë 2016-2020 dhe Plani i Veprimit për punësimin e të rinjve 2016-2020 është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Pakti Global i Punës i Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), Plani i Garancisë së Rinisë 2018-2019, Programi i Financimit të Buxhetit IPA, reformat në sistemin e mbrojtjes. Plani Operacional për programe aktive dhe masa për punësimin dhe shërbimet e tregut të punës për vitin 2019 përcakton programet, masat dhe shërbimet për punësim që do të sigurojnë krijimin e vendeve të punës, mbështetjen për krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e punësimit së të papunëve, personave veqanërisht të rinjë dhe përfituesit e ndihmës financiare sociale, etj.

3.5.1 Politikat aktive të tregut të punës në Maqedoni

Programet dhe masat e punësimit

1. Mbeshtetja e vetëpunësimit (sipërmarrësit)

Programi i vetëpunësimit dhe mbështetjes është destinuar për personat e papunë, me nisjen e biznesit vetëjak. Qëllimi i këtij programi është që të ofroj mbështetje për personat e papunë që janë të regjistruar në APRMV, ofrohet mbështetje financiare deni më 307.500 denarë apo deri në 615.000 denarë, në qoftëse themelohet një subjekt juridik me dy bashkëthemelues. Nga ky program mund të përfitojnë

- të rinjtë e papunë deri në moshën 29 vjeç.
- Të papunët me aftësi të kufizuara
- Të papunët
- Femrat e papuna që vijnë nga kategoritë vulnerabil dhe të marginalizuara
- Të papunët që synojnë formalizimin e biznesit të vetë
- Romët e papunë

2. Mbështetja e krijimit të vendeve të reja të punës

Mbështetja e krijimit të vendeve të punës do të inkurajojë punësimin e të papunëve në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, ndërmarrjet sociale që përqëndrohen kryesisht në qëllimet sociale/shoqërore dhe fitimet e të cilave po rinvestohen për të arritur ato qëllime përmes operacioneve afariste ose investimeve në komunitetet dhe organizatat civile (jofitimprurëse) që merren me aktivitet ekonomike në kryerjen e një veprimtarie, pra një aktivitet që klasifikohet me Klasifikim Kombëtar të Veprimtarive, me të cilin organizatat arrijnë qëllimet e tyre të përcaktuara në statut. Mbështetja e punësimit mund të jetë në formën e një subvencionit të

pagave, ose në formën e një granti për të blerë pajisje dhe / ose materiale të reja. Titulli i kësaj masë është subvencionimi i pagave dhe ka për qëllim mbështetjen e punësimit të personave të papunë që e kanë më të vështirë të inkuadrohen në tregun e punës. Në kuadër të kësaj mase përfshihen personat e papunë të regjistruar në APRMV që e kanë më të vështirë të inkuadrohen në tregun e punës:

- Personat që janë të papunë për një kohë të gjatë (mbi 12 muajt të regjistruar, ku përparësi kanë çersonat që janë papunë për më tepër se 5 vjet).
- Të rinjtë deri në 29 vjeç dhe personat mbi 50 vjeç.
- Përfituesit e asistencës minimale të garantuar
- Përfituesit e asistencës financiare me bazë papunësia
- Personat që kanë pasur statusin e fëmijëve pa prindër dhe pa kujdes prindëror.
- Viktimat e dhunës në familje
- Personat me aftësi të kufizuara
- Femrat pjestare të komunitetit etnik rom dhe komuniteteve të tjera etnike.
- Pjestarët e komunitetit etnik rom
- Personat të cilëve u është zgjedhur statusi me dokumentacionin personal
- Prindërit e vetëm
- Prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta
- Prindërit e 3 apo me tepër femijëve
- Prindërit e fëmijëve në rrugë
- Personat e dënuar pas lëshimit nga institucioni ndëshkimor-korrektues
- Personat e pa streh
- Personat me shkollën e mesme të pakryer ose me arsim të ulët.

Shuma e mbështetjes financiare është 19.000 denar në muaj, si subvencion i pagës së personit të punësuar për periudhën nga 3, 6 ose 12 muaj për punësimin e personave nga rendi i grupeve qëllimore. Punëdhënësi mund ti paguar punëmarrësit me një pagë edhe më të lartë. Mbështetja e plot financiare për një person për 3 muaj arrin 57.000 denarë, për 6 muaj arrin 11.4000 denarë dhe për 12 muaj arrin 228.000 denarë. Nga kjo mbështetje mund të përfitojnë kompanit mikro, të vogla dhe të mesme, ndërmarrjet sociale dhe organizatat e shoqërisë civile (jofitimprurëse) që merren me një aktivitet ekonomik në kryerjen e veprimtarisë së tyre.

2.1 Punësimi dhe rritja e subjekteve juridike

Qëllimi i kësaj mase është mbështetja e krijimit të vendeve të reja të punës në ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme, ndërmarrjet sociale dhe organizatat e shoqërisë civile. Mbështetja e punësimit të ri deri në 460.000 denarë, 768.750 denarë apo 1.000.000 denarë në varësi nga moshë dhe numri i punësimeve të miratuara. Shuma e garantit të punësimit të një personi në moshën mbi 29 vjeç arrin 92.000 denarë, për personat deri në 29 vjeç shuma e garantit arrin 153.750 denarë, ndërsa për përfituesit e asistencës minimale të garantuar dhe për persona të

papunë të komunitetit etnik rom shuma e garantit për një punëdhënës arrin 200.000 denarë. Këtë mbështetje mund ta shfrytëzojnë:

- personat e papunë të regjistruar në APRMV,
- ndërmarrjet mikro të vogla dhe të mesme, ndërmarrjet sociale dhe organizatat e shoqëris civile të interesuara për hapjen e vendeve të reja të punës.
- Ndërmarrjet e reja të themeluara me anë të Programit të Vetëpunësimit.

2.2 Mbështetja e punësimit të personave me aftësi të kufizuara

Qëllimi i kësaj mase është të rris kapacitetin dhe mundësit e punësimit të personave të regjistruar si të papunë dhe me aftësi të kufizuara. Përfitues të kësaj mase janë;

- personat me aftësi të kufizuar, të cilët në mënyrë të mëvetësishme kryejnë veprimtari si tregtar i vetëm, punëdhënës apo kanë cilësin e punëdhënësit.
- Shoqërit tregtare për punësimin e personave me aftësi të kufizuara - shoqërit mbrojtëse
- Administrata shtetërore
- Njësit e vetëqeverisjes lokale dhe Qyteti i Shkupit
- Ndërmarrjet publike, agjencitë, fondet dhe institucionet tjera shtetërore.

3. Trajnimet

Trajnimet kanë për qëllim përmisimin e shkathtësive dhe kualitative të personave të papunë për integrimin e tyre të sukseshëm në tregun e punës.

3.1 Trajnimi në vendin e punës për një punëdhënës të njohur

Kjo masë synon përfitimimin e shkathtësive të personat e papunë për kryerjen e detyrave të punës konform nevojave të punëdhënësit. Përfituesit të kësaj mase janë:

- Personat e papunë të regjistruar në APRMV
- Punëdhënësit

3.2 Trajnim për kualifikime profesionale me kërkesë të punëdhënësve

Kjo masë synon ofrimin e një trajnimi për kualifikime profesionale të zbatuara nga trajnerë të verifikuar me kërkesë të punëdhënësve. Trajnimi do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me punëdhënësit dhe ofruesit e trajnimit. Përfituesit të kësaj mase janë:

- Personat e papunë të regjistruar në APRMV
- Punëdhënësit

3.3 Trajnimet profesionale me kërkesë të punëdhënësve

Kjo masë synon ofrimin e trajnimeve për kualifikime profesionale me kërkesë të punëdhënësve. Trajnimi do të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat. Përfituesit të kësaj mase janë:

- Personat e papunë të regjistruar në APRMV
- Punëdhënësit

3.4 Trajnime mbi profesionet e kërkuara

Qëllimi i kësaj mase është që përmes trajnimit të përmbushet nevojat për profesionistët e kërkuar, shërimet sociale, dhe kualifiket që qojnë drejt vendeve të gjelbra të punës, e-tregtia. Përfituesit të kësaj mase janë:

- Personat e papunë të regjistruar në APRMV

3.5 Trajnime për shoferë në kategorinë C dhe D

Qëllimi i kësaj mase është rritja e kapacitetit të punësimit të personave të papunë të regjistruar duke përfutur shkaathtësi, në përputhje me kërkesat në profesionin e trafikut dhe nevojat e shprehura për krah pune në këtë degë ekonomike dhe punësimin e tyre. Përfituesit të kësaj mase janë:

- Personat e papunë të regjistruar në APRMV

4. Trajnimet për zhvillimin e shkathtësive digjitale

4.1 Trajnime për shkathtësi të avancuara TI

Qëllimi i kësaj mase synon të azhurnojë aftësitë e të rinjve të papunë në moshën deri në 34 vjeç në fushën e teknologjisë së informacionit në mënyrë që të rritet konkurrenca e tyre dhe integrimi më i shpejtë në tregun e punës. Përfituesit të kësaj mase janë:

- Personat e papunë të regjistruar në APRMV

4.2 Trajnime për shkathtësi të avancuara të TI (më bashkëfinancim) për trajnerë të palicencuar

Kjo masë synon të azhurnojë shkathtësitë e të papunëve me minimum arsim të mesëm në fushën e teknologjisë së informacionit në mënyrë që të rritet konkurrenca e tyre dhe integrimi i tyre më shpejtë në tregun e punës. Përfituesit të kësaj mase janë:

- Personat e papunë të regjistruar në APRMV

5. Punë Praktike

Qëllimi i kësaj mase është përfitimi i njohurive praktike të punës dhe shkathtësive të nevojitura për kryerjen e detyrave të punës në vende të caktuara të punës. Përfituesit të kësaj mase janë:

- Personat e papunë deri në 34 vjeç me minimum arsim të mesëm
- Punëdhënës nga sektori privat dhe ai civil.

6. Programi i angazhimit me punë

Programi siguron përfshirjen sociale të personave që e kanë më të vështirë të punësohen në mënyrë që të fitojnë shkathësi të caktuara dhe përfshirjen e tyre graduale në tregun e punës, me anë të implementimit të projekteve të infrastrukturës komunale dhe mbrojtjes së mjedisit në nivel lokal.

6.1 Punime Publike

Qëllimi i kësaj mase është inkuadrimi i të papunëve me kualifikime të ulëta në projekte të infrastrukturës dhe mbrojtjes së mjedisit në nivel lokal. Përfituesit të kësaj mase janë:

- Të papunët nga regjistrat e APRMV me kualifikime të ulëta, me prioritet personat t cilëve do tu zgjidhet statusi me dokumentacione personale
- Njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe Qyteti i Shkupit.

3.5.2 Politikat Pasive të tregut të punës në Maqedoni

Në mënyrë që të kualifikohet për përfitim financiar, një person i papunë duhet të ketë një kohë të punësimit të paktën 9 muajsh dhe me orar të plotë, ose të paktën 12 muaj me orar të pjesshëm të kohës së punësimit gjat 18 muajve të fundit. Shuma e përfitimit të papunësisë është e ndryshme, nga 40% e pagës mesatare të marrë për gjatë 12 muajve të fundit të periudhës së punësimit për ata që marrin përfitime financiare më shumë se 12 muaj dhe 50% për ata që marrin përfitimi financiare më pak se 12 muaj. Periudha e drejtë e përfitimit financiar është e ndryshme nga 3 muaj për ata që kanë një periudhë kohore të punësimit të paktën 9 muaj, deri në 18 muaj për ata që kanë një periudhë kohore të punësimit më shumë se 20 vjet. Ata me më shumë se 25 vite kanë të drejtë të marrin përfitim financiar deri në punësimin e ardhshëm apo pension.

Sigurimi shëndetësor është i detyruar për të gjithë qytetarët në Maqedoni. Në mënyrë që të plotësojë kriteret për prëdorimin e sigurimit shëndetësor të papunësisë, një person i papunë duhet të jetë i regjistruar në zyrën për punësim dhe të deklarojë se nuk ka asnjë mënyrë tjetër për tu siguruar.

Numri i personave me asistencë financiare ka rënë në vitet e fundit, si rezultat i pjesëmarrjes së lartë të të papunëve afatgjatë dhe i kriterve të vështira të përshtatshmërisë. Përfitimi i daljes në pension të hershëm nuk është përdorur gjërësisht për shkak të legjisllacionit të ashpër. Shuma e

paguar për politikat pasive të tregut të punës si shumë e PBB-së ka rënë gjatë viteve 2016-2017, por ende mbetet e lartë krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Gati dy të tretat e të hollave janë shpenzar për sigurim shëndetësor dhe në fondin e pensioneve, ndërsa një e treta është alokuar për përfituesit. Politikat e tregut të punës në vendet e Ballkanit Perëndimor ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme sipas programeve dhe personave të përfshirë. Ndërkaq shpenzimet për papunësinë në Maqedoni janë të larta në krahasim me vendet e UE-27, kush vetëm 7,5% e totalit të regjistruar tët të papunëve marrin përfitime financiare.

Por, sipas të dhënave nga Agjensia për punësim, politikat pasive të tregut të punës janë rritur në aspektin e numrit të marrësve të asistencës sociale. Gati 7,2% e të papunëve të regjistruar kanë marrë përfitime financiare papunësie në vitin 2018. Kjo nënkupton 24648 të papunësuar nga numri i përgjithshëm i të evidentuarve si të papunë në Agjencionin për Punësim. Në krahasim me vitin 2017 ky numër është rritur me 1083 apo 4,6%

Tregu i punës në Maqedoni shquhet për normë të lartë të papunësisë, prej rreth 32% në pesë vitet e fundit, të kombinuar me normën e ulët e aktiviteti (56,6%) dhe normë të ulët të punësimit (43,3%). Papunësia është më e shprehur tek popullsia e re, ndërkaq personat e papunë afatgjatë kanë pjesëmarrje më të madhe në numrin e përgjithshëm të të papunëve. Në fakt personat që nuk janë të punësuar një vit e më shumë përbëjnë 83% nga numri i përgjithshëm i të papunëve, prej të cilëve 76% janë persona të cilët janë të papaunë katër e më shumë vite. Këta persona inkuadrohen me shumë më tepër vështirësi në tregun e punës, kjo gjendje tregon për humbje të konsiderueshme të kapitalit njerëzor. Rrjedhimisht pjesa më e madhe e masave dhe politikave aktive që janë zbatuar në periudhën e fundit, parasegjithash janë të orientuara pikërisht nga grupet e synuara të lartë përmenduara.

4.VLERËSIMI EKONOMETRIK I HULUMTIMI.

4.1 Zgjedhja e variablave të modelit dhe metodologjia

Përpara së të raportojmë rezultatet e vlerësimit, është e nevojshme të sqarojmë disa çështje që lidhen me variablat e përfshira në regresion. Zgjedhja e variablave është bazuar në analizën e kapitullit të rishqyrtimit teorik, në lidhje me marrëdhënien që ekziston midis inflacionit dhe rritjes ekonomike dhe papunësisë.

Detajet lidhur ndërmjet këtyre variablave në këtë çështje trajtohen duke u bazuar në të dhënat që janë siguruar nga burimet zyrtare të informacionit të Bankës Qëndrore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të Entit Shtetëror Statistikor për një periudhë gjashtëmbëdhjetë vjeçare (2004-2019) në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Bazuar në literaturë dhe objektivat e këtij studimi, modeli i regresionit është specifikuar si më poshtë:

$$UNEMP = f(INF, GDP, EXP, IMP, INTEREST)$$

$$UNEMP_t = \beta_0 + \beta_1 + \beta_2GDP + \beta_3EXP + \beta_5IMP + \beta_6INTEREST + \varepsilon_t$$

ku,

UNEMP = Norma e papunësisë

INF = Norma e inflacionit

GDP = Produkti i brendshëm bruto

EXP = Vëllimi i eksportit

IMP = Vëllimi i importit

INTEREST = Norma reale e interesit

Pra modeli është ndërtuar duke marrë normën e papunësisë si variabël të varur, ndërsa si variabla të pavarura, ndikimi i të cilave shprehet ndaj normës së papunësisë janë marrë normat e inflacionit, PBB, Eksporti, Importi dhe Norma reale e intersit.

Gjatë kësaj analize janë përdorur 64 vëzhgime, duke përfshirë periudhën kohore 2004-2019 në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Të dhënat e përfshira në model janë të dhëna tremujore të marra nga Banka Qëndrore e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Entit Shtetëror Statistikor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Norma e inflacionit e matur nga indeksi i çmimeve të konsumit përfaqëson ndryshimin vjetor në përqindje të kostos së një shporte fikse mallrash dhe shërbimesh të një familje tipike, për

periudhën korrente krahasuar me një periudhë tjetër e konsideruar si periudha bazë. Të dhënat mbi normën e rritjes vjetore në përqindje të PBB-së janë të shprehura me çmimet e tregut në monedhën vendase.

Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) është një tregues i vlerës së tregut të të gjitha të mirave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara në një shtet. PBB përfshin gjithë prodhimet dhe shërbimet aktuale të destinuara për në treg, si dhe ato të prodhuara për konsum për vete nga të gjitha njësitë rezidente që veprojnë në territorin e një shteti. Ai gjithashtu përfshin taksat mbi produktet, përfshirë taksën e vlerës së shtuar dhe taksën doganore, duke zbritur subvencionet mbi produktet dhe importet. Papunësia i referohet pjesës së fuqisë punëtore që është e papunë, por në gjendje për të kërkuar punë.

Eksporti në ekonomi nënkupton transportimin e të mirave ose materialeve nga një vend në një tjetër në mënyrë legjitime, sipas rregullave dhe standarteve të vendeve pjesëmarrëse në një shkëmbim mallrash ose të mirash. Eksportimi i mallrave bëhet drejt konsumatorëve të huaj në një shtet tjetër nga shteti prodhues i atyre mallrave, ndërsa importi në ekonomi njihet si transporti apo hyrja e të mirave, produkteve nga një vend në një vend tjetër në mënyrë legjitime dhe sipas politikës ekonomike të përcaktuar nga vendet pjesëmarrëse në tregti.

Në vijim paraqitet hipoteza për shenjatat e variablave shpjeguese:

- Inflacioni, siç thuhet nga kurba e Philips-it, është e lidhur negativisht me papunësinë. Kjo do të thotë se, në qoftë se kërkesa për punë rritet për shkak të një zgjerimi monetar ekspansionist, shkalla e papunësisë do të ulet duke shkaktuar që raporti paga – çmime të rritet. Kështu do të krijohet një trade-off midis inflacionit dhe papunësisë.
- Bazuar në ligjin e Okun-it, do të thotë se koeficienti i Okun-it të jetë negativ, në mënyrë të tillë që rritja e shpejtë e prodhimit të shoqërohet me një ulje në normën e papunësisë dhe rritja e ngadalshme ekonomike apo negative të shoqërohet me normë të lartë të papunësisë (Knotek, 2007).
- Eksportet dhe rritja ekonomike janë ndër materialet më gjerësisht të hulumtuara nga akademikët dhe politikëbërësit. Ky interes i thellë shtrihet në analizën e fitimit nga promovimi i eksportit në biznes. Shumica e hetimeve dhe e torive thjesht bëjnë supozimin e nënkuptuar që industria e orientuar drejt eksportit luan rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike dhe në mirëqënien kombëtare. Nëse sektori i eksportit nuk ka ndikim në shumë aspekte ekonomike të një kombi, duke përfshirë tregun e punës, ai duhet të ketë një ndikim pozitiv mbi papunësinë, (Abdullah, 2006).
- Studime të ndryshme analizojnë ndikimin e globalizimit dhe rritjes së tregtisë ndërkombëtare në ekonomi. Kim (2011) ka bërë një studim për të ofruar një dëshmi empirike nëse tregtia ndërkombëtare ka ndonjë ndikim domethënës mbi papunësinë agregate në prani të institucioneve të tregut të punës. Duke përdorur të dhënat për njëzet vendet e OECD-së për periudhën kohore 1961-2008, rezultoi që vetëm importet rrisin papunësinë totale në një ekonomi.

- Nga teoritë ekonomike dimë që normat e interesit janë me të vërtetë kostoja me të cilën bizneset dhe konsumatorët financojnë shpenzimet e tyre. Kur normat e interesit janë të larta, huamarrja bëhet më e kushtueshme, dhe kështu bizneset dhe konsumatorët kanë nxitje për të hequr dorë nga konsumi aktual. Rriten kursimet, zvogëlohet konsumi dhe grumbullimi i papritur i inventarit. Për këtë arsye, firmat reduktojnë prodhimin kështu që zvogëlohet prodhimi i përgjithshëm. Me uljen e prodhimit, papunësia do të jetë gjithnjë në rritje, kështu që banka qendrore do të reduktojë normën e interesit për të përmisuar situatën dhe për të rritur konsumin dhe prodhimin. Një kanal shumë më tepër konvencional për efektin e normës reale të interesit në normë natyrore është nëpërmjet akumulimit të kapitalit. Norma reale të interesit ndikojnë koston e kapitalit, kostoja e kapitalit ndikon në akumulimin e kapitalit, stoku i kapitalit ndikon në kërkesën për punë, kërkesa për punë ndikon te papunësia. Prandaj është me rëndësi që politika monetare të jetë në gjendje të ndikojë te normat reale të interesit për një periudhë të gjatë kohore. (Blanchard 2003).

4.2 Ndërtimi i modelit ekonometrik për të shpjeguar ndikimin e inflacionit dhe rritjes ekonomike në papunësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Për të shpjeguar ndikimin e inflacionit dhe rritjes ekonomike në papunësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën kohor 1998-2013, është ndërtuar një model i regresionit të shumëfishtë, duke përdorur të dhëna në seri kohore për këtë periudhë.

Tabela 6. T-testi për rëndësin statistikore të modelit.

Seritë kohore	Gabimet standarte (St. Error)	T-testi (T-statistics)	Alfa e vëzhguar (P-values)
CONSTANT	2.260079	23.48261	0.0000
INF	0.075382	-4.290981	0.0001
GDP	0.700980	-8.156846	0.0000
EXP	0.001850	-5.575549	0.0000
IMP	0.001648	7.024792	0.0000
INTEREST	0.070795	4.810302	0.0000

Më sipër, kemi paraqitur T-testin e regresionit të shumëfishtë linear për secilën nga seritë kohore. Me anë të t-test (t-statistics) mund të testojmë ndikimin dhe rëndësinë statistikore të variablave në veçanti dhe në rast se të gjitha variablat e përfshira rezultojnë si të rëndësishme statistikisht atëherë edhe në përgjithësi modeli do të jetë i rëndësishëm. Sipas vlerave të modelit për (INF) kemi t-statistics = 4.290981 me probabilitet 0.0001; për (GDP) t-statistics = -8.156846 me

probabilitet 0.0000; për (EXP) t-statistics = -5.575549 me probabilitet 0.0000; për (IMP) t-statistics = 7.024792 me probabilitet 0.0000 dhe për (INTEREST) t-statistics = 4.810302 me probabilitet gjithashtu 0.0000.

Të gjitha variablat me probabilitet më të vogël se 5% tregojnë se janë variabla domethënëse në këtë model. Refuzojmë gjithnjë hipotezën zero në nivelin e paracaktuar 5%, pra pranojmë hipotezën alternative H_1 që janë seritë stacionare.

Gabimet standarte (s.e) tregojnë shmangjen mesatare të vlerësimeve nga vlera e vërtetë e parametrave. Na udhëzojnë se sa të sakta janë vlerësimet, sa më të vogla domethënëse sa aq më preciz dhe më të besueshëm janë koeficientët e vlerësuar. Me rritjen e numrit të observimeve, gabimet standarte janë të vogla.

P-values (Probability values) është niveli i saktë i sinjifikancës, i cili tregon fuqinë relative me të cilën mund të refuzojmë hipotezën zero për sinjifikancën e variablit në vlerat konvencionale të përqindjeve. Si zakonisht, në qoftë se vlera P-value është më e vogël se 0.05 (apo 5%), atëherë rezultati do të konsiderohet statistikisht i rëndësishëm (sinjifikant) dhe hipoteza zero do të refuzohet.

Pra, mund të procedojmë me vlerësimin e modelit me anë të metodës tradicionale regresioni linear "Metoda e katrorëve të vegjël".

Në tabelën më poshtë kemi paraqitur koeficientët e modelit të vlerësuar me anë të kësaj metode. Metoda tradicionale e katrorëve të vegjël njihet në ekonometri për vlerësimin e modelit të regresionit linear.

Në praktikë, optimizmi me anë të Metodës së katrorëve të vegjël kryhet duke minimizuar shumën e gabimeve të modelit në katrorë. Sipas kësaj metode modeli është konsistent kur regresionët janë ekzohjenë dhe nuk ka multikolineraritet. Për të patur parametra të vlerësuar drejtë, gabimet duhet të jenë homoskedastikë (me variacë konstante) dhe të pakorreluar me njëri-tjetrin. Një hipotezë shtesë që përodret është shpërndarja normale e gabimeve.

Në kolonën e dytë kemi vlerësimin e koeficientit për secilin variabël. Nga rezultatet shohim që parametrat janë të vlefshme statistikisht.

Në kolonën e tretë kemi nivelin e vëzhguar të alfës (ose p-value). Në bazë të alfës si vëzhguar për testin F hedhim poshtë hipotezën që modeli i vlerësuar është i pavlefshëm statistikisht sepse alfa është e barabartë me zero (pra më e vogël se 5%).

Tabela 7. Vlerësimi i modelit me metodën e Kartorëve më të vegjël.

Variabël e varur: UNEMP	Koeficientët	P- Vlerat
CONSTANT	53.072560	0.0000
INF	-0.323463	0.0001
GDP	-5.717787	0.0000
EXP	-0.010314	0.0000
IMP	0.011577	0.0000
INTEREST	0.340547	0.0000
F-statistic	19.11947	0.0000
R-Squared	0.622389	
Adjusted R-Squared	0.589837	

R^2 (R- squared) na tregon se sa afër janë observimet me vijën e regresionot. Vlera e këtij koeficienti janë $0 \leq R^2 \leq 1$. Nëse $R^2 = 1$, atëherë të gjitha observimet shtrihen në vijën e regresionit, kurse kur $R^2 = 0$, asnjë observim nuk shtrihet në vijën e regresionit apo vija e regresionit nuk ka asnjë aplikim. Për ta interpretuar koeficientin e determinacionit ai shëndrrohet në përqindje, gjegjësisht merr vlerat nga 0 – 100%.

Në shembullin tonë kemi një koeficienti dererminacioni $R^2 = 0.622389$, gjë që na tregon se rreth 62% e variacionit të normës së papunësisë shpjegohet nga variablat e pavarura, vetëm 38% e variacionit të papunësisë nuk mund të shpjegohet nga një ndryshim në ndonjë prej variablave në model.

Po ashtu testojmë sinjifikancën e R^2 me **F-testin** (F – statistoc), i cili tregon rëndësinë statistikpre të gjithë variavlave të pavarura bashkarisht. Vlera të larta të F- statistikës e hedhim poshtë hipotezën zero në favor të asaj alternative. Në këtë rast kemi **F- statistika** = 19.11947 **Prob.(F-statistic)** = 0.0000 që është më e vogël se 5%, një tregues sinjifikant i cili na tregon që variablat e pavarura së bashku në mënyre sinjifikante e sqarojnë variablën e varur.

Gjithashtu, koeficienti i vlerësuar i determiniacionit (Adjusted R-squared) na tregon që modeli i vlerësuar shpjegon rreth 59% të variancës së variablit të varur.

Përkatësishtë, modeli është shprehur në formën:

$$UNEMP_t = 53,072 - 0,3234INF - 5,7177GDP - 0,0103EXP + 0,0115IMP + 0,3400INTEREST$$

$$r^2 = 0,62238$$

$$F = 19,11947$$

$$p = 0.0000$$

Modeli tregon që marrëdhënia negative midis papunësisë dhe inflacionit ashtu siç na tregon edhe lakorja e Philips-it është e vertetë për Republikën e Maqedonisë së Veriut sa i përket periudhës kohore prej 1998-2013. Për një rritje në 1 % në normën e inflacionit, papunësia ulet me 0,3% dhe

rrjedhimishtë, duke mbështetur një trade-off mes inflacionit dhe papunësisë të sqaruar nga lakorja e Philips-it.

Nga ana tjetër, rezultaatet e studimit tregojnë gjithashtu se marrëdhënia mnegative midis papunësisë dhe rritjes ekonomike siç na tregon Ligji i Okun-it vlen për Republikën e Maqedonisë së Veriut. Për një rritje një milion euro në PBB, shkalla e papunësisë ulet me 5,7%.

Sa i përket ndikimit të eksportit në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë kësaj periudhe kohore shohim një lidhje të rëndësishme negative midis tyre, prandaj me rritjen e eksportit për 1 milion euro, papunësia ulet me 0,01%. Kjo lidhje na tregon mbi rëndësinë e nxitjes së eksportit të produkteve vendore për reduktimin e normës së papunësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Nga ana tjetër importi ka një lidhje pozitive me normën e papunësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kështu që me rritjen e importit për një milion euro norma e papunësisë rritet me 0,01%.

Ndërsa norma reale e interesit tregon një lidhje të drejtl me normën e papunësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë kësaj periudhe. Nga ekuacioni i modelit të vlerësuar shohim që me rritjen e normës reale të interesit për 1%, norma e papunësisë rritet me 0,3% gjatë kësaj periudhe kohore të analizuar.

Për vlerësimin e modelit janë bërë testime lidhur me faktin se modeli ka korrelacion serik apo jo, a është heteroskedastik apo jo dhe a ka shpërndarje normale apo jo.


Për të testuar autokorrelacionin është përdorur Breusch-Bodfrey Serial Correlation LM test. Nga ky shohim që kemi **OBS* R-squared = 44.18987** me probabilitet **Prob. = 0.0000** më e vogël se 5%, prandaj mund të refuzojmë hipotezën zero. Pra modeli ka korelacion serik të residualeve.

Për çdo observim, varianca e gabimit duhet të jetë konstante (homoskedastike). Në rast se kemi variancë të ndryshueshme cenohet njëri nga supotimet dhe modeli diagnostifikohet me heteroskedasticitet. Për të testuar nëse modeli ka heteroskedasticitet përdorim testin Breusch – Pagan – Godfrey nga i cili shohim që kemi **Obs* R-squared = 6.690083** me probabilitet **Prob. = 0.2447** që është vlerë më e madhe se 5% prandaj nuk mund të refuzojmë hipotezën zero. Pra, në këtë modeë redidualet nuk janë heteroskedastike.

Për të analizuar normalitetin (shpërndarja normale) bëjmë paraqitje grafike të shpërndarjes së gabimit. Në rast se përqindja aktuale i përfaqëson shpërndarjes normale atëherë testi i statistikës është i vogël dhe, nëse është larg nga normalja atëherë testi i statistikës është i madhe dhe supozimi nuk qëndron.

Në grafikun mëposhtëm, kontrollojmë nëse mbetet ndjekim ose jo shpërndarjen normale. Përshatje me drejtëzën e shpërndarjes normale është përgjithësisht e mirë, vërejmë disa probleme modeste në ekstremet e dretëzës. Histogrami paraqitet pothuajse simetrik rreth vlerës zero, pra modeli ynë nuk gabon mesatarisht.

Figura 17. Histogrami i modelit ekonometrik.



Nga ky test kemi treguesin **Jarque –Bera = 0,395416** me probabilitet **Prob. = 0.820609** që është më i madh se 5% dhe pranojmë hipotezën zero. Residualet janë të shpërndara normalisht.

4.2.1 Përfundime në lidhje me modelin

Analiza e modelit të regresionit të mësipërm kishte për qëllim të zbulonte se çfarë lloj lidhjeje dhe ndikimi egziston ndërmjet inflacionit dhe rritjes ekonomike në papunësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Analiza është bazuar në modelin OLS (Metoda e Katrorëve më të vegjël) të informacionit të Bankës Qëndrore në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Entit Shtetëror Statistikoje të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për periudhën prej vitit 1998-2013.

Analiza empirike bazar në modeln OLS të regresionit të inflacionit dhe rritjes ekonomike të papunësisë na jep vlerësim për masën e ndikimit të tyre në normën e papunësisë. Rezultatet tregojnë që këto variabëla të pavarura kanë ndikim tek variablat e varur.

Bazar në argumentet teorike, ky model regresioni linear me pesë variabla të pavarura tregon se lidhja e shprehur në këtë model është statistikisht e rëndësishme. Në studime të mëtejshme të thelluara, ekuacioni mund të pasurohet edhe me një numër më të madhe të vëzhgimeve, meqenëse analiza është bërë vetëm për periudhën prej 1998-2013. Gjithashtu mund të përfshihen edhe variabla të tjera që ndikojnë tek norma e papunësisë, si p.sh. reformat strukturore të tregut të punës, investimet, përfitimet e papunësisë, taksat, politikat e tregut të punës, pagat minimale, norma e këmbimit etj, por që aktualisht nuk janë objekt i kësaj qështjeje.

5.PËRFUNDIME DHE REKOMADIME

Politikat makroekonomike zbatohen në mënyrë që të arrihen objektivat kryesore të qeverisë për punëzënie të plotë dhe ekonomi të qëndrueshme me inflacion të ulët. Objektivi kryesorë i çdo programi ekonomik është që të arrihet një rritje të qëndrueshme ekonomike me një normë të ulët të inflacionit dhe papunësisë. Papunësia dhe inflacioni kanë qënë dhe do të mbeten gjithmonë prokupi kryesor i çdo politike ekonomike.

Maqedonia ashhtu si edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, vazhdon të luftojë me një rritje të ulët ekonomike dhe me një normë të lartë të papunësisë. Edhe pse recesioni si pasojë e krizës ekonomike globale, në krahasim me vendet e tjera të rajonit, në Maqedoni ishte më pak i theksuar, përsëri në nivel më të ulët në krahasim me periudhën pas krizës dhe kishte një trend shumë të ulët të rritjes. Normat e papunësisë në Maqedoni, Kosovë, Bonjë dhe Hercegovinë janë ndër më të lartat në Evropë.

Disa faktorë që kanë kontribuar në nivelet e larta të papunësisë janë: eksporti i ulët, niveli i ulët i investimeve të Huaja Direkte (IHD), rënia e aktivitetit ekonomik, ekonomia e madhe jofromale, politikat joefikase të tregut të punës dhe legjislacioni i ngurtë i tregut të punës.

Ndërsa, për sa i përket inflacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ai ka filluar të stabilizohet që nga viti 1996. Ka pasur zhvillime relativisht të qëndrueshme të politikës monetare, si për shembull zgjedhja e regjimit monetar duke adaptuar kurse fikse të këmbimit, si dhe inflacionin e targetuar. Ajo që na tregon trendet botërore, evropiane dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut është që vitet e fundit ka pasur periudha deflacioni, si rezultat i uljes së çmimeve të naftës dhe të mallrave të tjera në vendet e zhvilluara. Inflacioni paraqet objektivin e studimeve të shumta për caktimin e një niveli “prag” të arsyeshëm për një rritje të qëndrueshme në ekonomitë e vendeve të ndryshme.

Qëllimi i këtij punimi ishte që të paraqiste pikërisht lidhjen dhe ndikimin e inflacionit dhe rritjes ekonomike në papunësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhë kohore prej vitit 2004- 2019. Analiza empirike bazuar në Modelin e Katrorëve më të vegjël (OLS) të regresionit të inflacionit dhe rritjes ekonomike në papunësinë na jep vlerësim të një lidhje dhe ndikimi të rëndësishëm të këtyre variablave për këtë periudhë të analizuar. Për një rritje në 1% në normën e inflacionit, papunësia ulet me 0,3%, rrjedhimisht duke mbështetur një trade-off mes inflacionit dhe papunësisë sqaruar nga lakorja e Philips-it. Nga ana tjetër, rezultatet e studimit tregojnë gjithashtu se marrëdhënia negative midis papunësisë dhe rritjes ekonomike siç na tregon Ligji i Okun-it për Reepublikën e Maqedonisë së Veriut. Për një rritje 1 milion euro në PBB, shkalla e papunësisë ulet me 5,7%.

Sa i përket ndikimit të eksportit në papunësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë kësaj periudhe kohore, shohim një lidhje negative midis tyre. Çka do të thotë se me rritjen e eksportit për 1 milion euro, papunësia ulet me 0.01%. kjo lidhje na tregon mbi rëndësinë e nxitjes së

eksportit të produkteve vendore për ndikimin e normës së papunësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Nga ana tjetër, importi ka një lidhje pozitive me normën e papunësisë në Republikën e Maqedonisë së veriut, kështu që me rritjen e importit për një milion euro, norma e papunësisë rritet me 0,01%.

Ndërsa norma reale e interesit tregon një lidhje të drejtë me normën e papunësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë kësaj periudhe. Nga ekuacioni i modeli të vlerësuar shohim që me rritjen e normës reale të interesit për 1%, norma reale e papunësisë rritet me 0,3% gjatë kësaj periudhe kohore të analizuar.

Në bazë të rezultateve të këtij punimi shohim që inflacioni, rritja ekonomike dhe eksporti kanë lidhje të zhdrejtë me papunësinë, ndërsa lidhje të drejtë me të kanë importi dhe norma reale e interesit. Kështu që mund të rekomandojmë politika të tilla, të cilat nxisin rritjen e PBB-së dhe eksportin, dhe uljen e importit dhe normës reale të interesit.

Ndërsa përsa i përket inflacionit, Republika e Maqedonisë së Veriut ndjek inflacion të targetuar, mirëpo në një mjedis të tillë, autoriteti monetar ka një objektiv zyrtar, i cili është vlera e kursit të këmbimit, por instrumentimi i saj, norma e politikës sipas Shamloo (2011), lejon një hapësirë për manovrim dhe kështu autoriteti monetar mund të zgjedh për të synuar inflacionin në një kohë kur nuk ka presion mbi rezervat valutore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Gjithashtu duhet ndjekur politikat e investimit në arsim dhe në trajnime profesionale të kapitalit njerëzor dhe modernizimin e institucionvet të tregut të punës, duke patur objektiva të qarta dhe të matshme, stimulime financiare për zgjerimin e firmave të vogla dhe të mesme dhe kalimin e bizneseve nga ekonomia joformale në atë formale.

Rëndësi të madhe për reduktimin e papunësisë kanë edhe politikat e tregut të punës, sipas Agjencionit për Punësim në Republikën e Maqedonisë së Veriut, politikat aktive të tregut të punës të cilat kanë qënë më të sukseshme në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë Programi për vetëpunësim dhe Programi për subvencione të punësimit, të cilat duhet të rriten dhe të rritet gjithashtu edhe efikasiteti i tyre.

Në krahasim me vendet e tjera të rajonit, Republika e Maqedonisë së Veriut ka një përqindje të ulët të shpenzimeve për politikat e tregut të punës në PBB, por ka një përqindje të lartë të shpenzimeve për politikat pasive të tregut të punës, në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Sa i përket kësaj strukture të shpenzimeve të politikave të tregut të punës, Maqedonia duhet të rrisë shpenzimet për politikat aktive të tregut të punës duke reduktuar nga ana tjetër shpenzimet për politikat pasive të tregut të punës.

REFERENCAT

- Agenor. P.R and A.W. Hoffmaister (1997). Money, Wages and Inflation in Middle-Income Developing Countries. International Monetary Fund Working Paper, WP/97/174.
- Aghion. P. And Howitt, P (1992). A Model of Growth through Creative Destruction. *Econometrica* 60: 323 – 351
- Aghion. P. And Howitt, P. (1994). Growth and unemployment. *Review of Economic Studies*, 61, 477- 494.
- Alfredo. S F. (2005). Pro-poor Monetary and Anti-Inflation Policies: Developing Alternatives to the new Monetary Policy Consensus, manuscript, Department of Development Studies, SOAS.
- Agjensioni për punësim i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2009), Raporti vjetor, Prill 2009.
- Agjensioni për punësim i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2016)
- Banka Popullore e Maqedonisë së Veriut (2014) Indikatorët kryesorë makroekonomik. BPRM, Dhjetor, 2014.
- Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (2016). Indikatorët kryesorë makroekonomik, BPRM, Prill 2016
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (2009). Politikat makroekonomike e RM-së për vitin 2010, Shkup, Dhjetor.
- Aziri. E. (2002). Proceset dhe lëvizjet socio-ekonomike në Pollog, Logos-A, Shkup.
- Aokil. M and Yosshikawa. H. (2003). A New Model of Labor Dynamics: Ultrametrics, Okun's Law, and Transient Dynamics, Springer Berlin Heidelberg, Volume 550, 203-219.
- Apergis. N and Rezitis. A. (2003). An examination of Okun's law: evidence from regional areas in Greece, *Applied Economics*, 2003, 35, 1147-1151.
- Barro. R. (1995). Inflation and Economic Growth, NBER Working Paper. 5326.

- Bassanini. A and Duval R. (2006). The determinants of unemployment across OCED countries: reassessing the role of policies and institutions, OECD Economic Studies No. 42, 2006/1.
- World Bank (2013). “Doing Buisness in Macedonia, FYR 2013”, Retrieved 2012-10-21.
- World Bank (2015), World Development Indicators, Aprill 2015, <http://dataworldbank.org>
- Yagler. M. (2006). Does economic growth echibit a different impact on job creation and job destruction?, Scottish Journal of Pulitival Economy (Impact Factor: 0.21). 02/2006; 53(5):672-683.
- William. S. (2005). Examining the Reationship between Emplizment and Economic Growth in the Ten Largest States “Southwestern Economic Reviw.
- U . S Department of State-Bureau of European Affairs, (2011), March, <http://www.state.gov>
- State Statistical Office of the Republic of Macedonia; <http://www.state.gov.mk/>
- Trpeski. P and Tevdovski. D. (2015). Nairu Estimates ina Transitional Economz With an Extremely High Unemployment Rete: The casse of the Republic of Macedonia, ECONOMIC ANNALS, Volume LX, No. 206 / July – September.
- Phillips. A. W. (1958). The Relation between unemployment and the rate of change of money wage rates in the United Kingdom, 1861-1957. *Economica*, 25(100).
- Scheibe. J and Vines. D. (2005). A Phillips Curve for China. CAMA working paper, retrieved from: http://economics.ouls.ox.ac.uk/11544/1/Scheive_Vines_022005.pdf
- Ministria e Financave të Republikës së Maqedonisë së Veriut (2013). Raport vjetor Ekonomik Prill 2013
- Ministria e Financave të Republikës së Maqedonisë së Veriut (2014). Raport vjetor ekonomik, Janar 2014.
- Enti Statistikor i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2009), Raort vjetor, Prill 2009.
- Enti Statistikor i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2015), Raport vjetor, Prill 2015.

- BPRM (2010), Raport vjetor i punësimit të BPRM-së në vitin 2009, Shkup, Mars 2010.
- Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (2014), I
- Umair. M. And Raza U. (2013) Impact of GDP and inflation on unemployment rate of Pakistan Economy in (2000 -2010). Retrieved from <http://irmbrjournal.com/papers/137152025.pdf>
- Bakare. A.S. (2012). Stabilization policy, Unemployment Ceises and Economic Growth in Nigeria, Universal Journal of Management and Social Sciences, Vol. 2, No. 4.
- Ball, Laurence, and Robert Moffitt (2001). “ Productivity Growth and the Phillips Curve”. NBER Working Paper 8421, August.
- Ball. L. and G. Mankiw (1994). What Determines Sacrifice Ratio? Monetary Plicy. 1st Edn. University of Chicago Press, Chicago.
- Ball. L. amd Mankiw. G. (1994). Asymmetric Proce Adjustment and Economic Fluctuations. Economic Journal, v.104, N.423,247-261.
- Bassanini. A and Duval. R. (2006). The determinants of unemployment across OCED Countries: reassessing the role of policies and institutions, OCED Economic Studies No.42,2006/1.
- Bean. C.R. and C. Pissarides (1993). Unemployment Consumption and Growth, European Economic Review, Vol. 37, No. 4, pp. 837-854.
- Bean. C. R. (1997). Discussion of R. Gordon: Is there a Trade-Off Between Unemployment And Productivity Groth, IN D: J: Snower and G. de la Dehesa, eds, Unemployment Plicy Government Options for the Labor Market, Cambrige University Press, Cambridge, 464-465.
- Berentsen. A. Menzio. G: and Wright. R. (2011), INflation and Unemployment in the Long Run, American Economic Reviw 101 (February 2011): 371-398.
- Berentsen. A. Breu. M. and Shi. S. (2012), Liquidity, Innovation, ang growth, Journal of Monetary economic, 59, 721-737.

Dependet Variable: N_PAPUNESIS:

Method: Least Squares

Date: 20/03/21 Time: 14:35

Sample: 2004Q1 2019Q4

Included observations: 64

Variable	Coefficient	Std.Error	t-Statistic	Prob.
C	53.07256	2.260079	23.48261	0.0000
INTEREST-RATE	0.340547	0.070795	4.810302	0.0000
INFLATION_	-0.323463	0.075382	-4.2902981	0.0001
IMPORTO	0.011577	0.001648	7.024792	0.0000
GDP	-5.717787	0.700980	-8.156846	0.0000
EKSPORTI	-0.010314	0.001850	-5.575549	0.0000

R-squares	0.622389	Meand dependent var	33.31712
Adjusted R-squares	0.589837	S.D dependent var	2.561530
S.E of regression	1.640506	Akaike info criterion	3.916946
Sum squared resid	156.0931	Schwarz criterion	4.119342
Log likelihood	-119.3423	Hannan-Quinn criter.	3996680
F-statistic	19.11947	Durbin-Watson stat	0.395863
Prob(F-statistic)	0.000000		

Heterosedasticity Test: Breusch-Pagan-Godfrey

F-statistic	1.354128	Prob. F(5.58)	0.2550
Obs*R-squared	6.690083	Prob. Chi-Square(5)	0.2447
Scaled explained SS	4.488876	Prob. Chi-Square(5)	0.4814

Test Equation:

Dependet Variable: RESID^2

Method: Least Squares

Date: 20/03/21 Time: 14:37

Sample: 2004Q1 2019Q4

Included observations: 64

Variables	Coefficient	Std.Error	t-Statistic	Prob.
C	11.24659	4.269435	2.634211	0.0108
INTEREST_RATE	0.220482	0.133737	1.648623	0.1046
INFLACIONI_	-0.097364	0.142402	-0.693727	0.4969
IMPORTI	0.002297	0.003113	0.737880	0.4636
GDP	-1.728823	1.324197	-1.305564	0.5411
ESPORTI	-0.002148	0.003495	-0.614795	0.5411

R-squared	0.104533	Mean dependent var	2.438954
Ajdusted R-squared	0.027337	S.D. dependent var	3.142269

S.E. of regression	3.099021	Akaike info criterion	5.189110
Sum squared resid	557.0281	Schwarz criterion	5.391505
Log likelihood	-160.0515	Hannan-Quinn criter.	5.268843
F-statistic	1.354128	Durbin-Watson stat	1.076591
Prob(F-statistic)	0.254951		

Breusch-Godfrey Serial Correlation LM Test:

F-statistic	62.45875	Prob. F(2.56)	0.0000
Obs*R-squared	44.18987	Prob. Chi-square(2)	0.0000

Test Equation:

Dependent Variable: RESID

Method: Least Squares

Date: 20/03/21 Time: 14:40

Sample: 2004Q1 2019Q4

Included observations: 64

Presample missing value lagged residuals set to zero.

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	0.082597	1.303898	0.064113	0.9491
INTEREST_RATE	0.020887	0.040271	0.518660	0.6060
INFLACIONI_	0.009552	0.0136679	0.218681	0.8277

IMPORTI	-0.000169	0.000949	-0.177899	0.8594
GDP	0.139534	0.409999	0.340325	0.7349
EXSPORTI	-7.66005	0.001051	-0.072897	0.9421
RESID(-1)	1.093902	0.126861	8.622827	0.0000
RESID(-2)	-0.358022	0.130570	-2.696046	0.0092

R-squared	0.690467	Mean dependent var	-1.160014
Adjusted R-squared	0.651775	S.E. dependent var	1.574061
S.E. of regression	0.928863	Akaike info criterion	2.806757
Sum squared resid	48.31601	Schwarz criterion	3.076617
Log likelihood	-81.81622	Hannan-Quinn criter.	2.913069
F-Statistic	17.84536	Durbin-Watson stat	1.993624
Prob(F-statistic)	0.000000		
